

POTENCIALI I **BRE-VE**
TË VOGLA NË ASPEKTIN
E TRANZICIONIT ENERGETIK
NË KOSOVË

Autorë:
GET GROUP L.L.C

Klauzolë për shmangien e përgjegjësisë

Ky dokument është hartuar për Odën Ekonomike Gjermano – Kosovare (OEGJK), në kuadër të projektit "Network for Clean Energy Business (N4CEB)", i mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Pikëpamjet e hartuesit të këtij dokumenti si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së dhe as të OEGJK-së.

Mbështetur nga:



PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky studim hulumtues u zhvillua pas shpalljes së thirrjes së hapur për ofertime nga Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare, e mbështetur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Studimi hulumtues u zhvillua në përputhje me Termat e Referencës, ndërsa përqendrohet tek potenciali i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në aspektin e tranzicionit energjetik në Kosovë.

Kapitulli i tretë i studimit shqyrton tranzicionin energjetik të BE-së dhe progresin e deritanishëm të Kosovës në lidhje me reformat energjetike. Duke pasur parasysh që vetëm projektet e vogla të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë janë ato që kanë të bëjnë me vetë-konsum. Kapitulli i katërt i studimit përqendrohet tek korniza ligjore dhe rregullative, duke përfshirë kapacitetin e instalimit, skemat mbështetëse dhe potencialin e ardhshëm të ripërtëritjes. Kapitulli i pestë përqendrohet tek barrierat me të cilat përballet komuniteti i bizneseve në zhvillimin, instalimin dhe implementimin e projekteve të vogla të energjisë së ripërtëritshme. Ky kapitull përfshinë gjetjet nga hulumtimi i kryer në terren, i cili u zhvillua me anë të pyetësorëve dhe intervistave me komunitetin e biznesit dhe shoqatat e bizneseve lokale, si dhe përmes takimeve dhe komunikimit me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë.

Studimi nxjerr në përfundim rekomandimet mbi mënjanimin e barrierave për të mundësuar një tranzicion efikas të energjisë.

LISTA E SHK

SHK - shpenzimet kapitale

CO₂ - dioksidi i karbonit

OSSh - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

BE - Bashkimi Evropian

ZRrE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë

GWh - gigavat orë

KEDS - Shërbimet e Shpërndarjës së Energjisë Elektrike në Kosovë

KESCO - Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike

URTESAVE

kV - kilovolt

kW - kilovat

PV - fotovoltaik

BRE - burimet e ripërtëritshme të energjisë

PE-BRE - prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë

PEN&F – BRE - prodhimi i energjisë për ngrohje dhe ftohje nga burimet e ripërtëritshme të energjisë

BRE-T - burimet e ripërtëritshme të energjisë në transport

PËRMBAJTJA

Përmbledhje e përgjithshme	3
Lista e shkurtesave	4
Tabela e figurave	7
1. Hyrje	8
2. Metodologjia	10
3. Tranzicioni i sektorit të energjisë në Evropë dhe progresi i Kosovës në këtë drejtim	12
3.1. Progresi i Kosovës në aspektin e tranzicionit energjetik	14
4. BRE-të e vogla në Kosovë	17
4.1 Korniza ligjore dhe rregullative për ndërtimin dhe funksionimin e BRE-ve të vogla	17
4.2. Vetë-konsumi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë nga impiantet që janë të inkuadruara në rrjetin e distribuimit	20
4.3. Skemat mbështetëse për impiantet e BRE-ve të vogla për vetë-konsum që janë të integruara në rrjet	21
4.4 Potenciali i ardhshëm i sistemeve solare fotovoltaike	22
5. Barrierat me të cilat përballen zhvilluesit e BRE-ve të vogla	25
5.1. Barrierat ligjore dhe rregullative	26
5.2. Procedurat administrative për autorizim të BRE-ve të vogla	27
5.2.1 Rezultatet e hulumtimit nga terreni	34
5.3 Barrierat fiskale dhe problemet financiare	36
5.3.1 Rezultatet e hulumtimit nga terreni	37
5.4 Ndërlikimet e Covid -19 në projektet e BRE-ve	38
5.4.1 Rezultatet e hulumtimit nga terreni	39
6. Konkluzionet dhe rekomandimet	40
6.1 Rekomandimet	42
7. Referencat	44
8. Shtojca 1 Pyetëtori	48

TABELA E FIGURAVE

Figura 1: Projektet e autorizuara të PE-BRE-ve të vogla për vetë-konsum (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e regjistrit të ZRrE-së mbi aplikacionet për prodhuesit për qëllime të vetë-konsumit).	21
Figura 2: Potenciali i energjisë fotovoltaike: Kosovë (Banka Botërore 2019b).	23
Figura 3: Rrezatimi global në rrafshin horizontal: Kosovë (Banka Botërore 2019a).	24
Figura 4: Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për autorizim pranë ZRrE-së (shifrat e autorit bazohen në të dhënat nga Rregullorja e ZRrE-së për autorizimin).	28
Figura 5: Dokumentet e kërkuara për pëlqimin komunal (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).	29
Figura 6: Dokumentet e nevojshme për t'u lidhur me rrjetin (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).	30
Figura 7: Dokumentet për rivlerësimin e aprovimit teknik / shtimit të energjisë (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).	30
Figura 8: Dokumentet për rivlerësimin e aprovimit teknik / shtimit të energjisë (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).	31
Figura 9: Dëshmia dokumentare e aplikimit për njehsorin e energjisë dykahore (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).	32

HYRJE

Tranzicioni energjetik është një orientim global ku vendet anembanë botës synojë ta dekarbonizojnë sektorin energjetik me zero-karbon deri në vitin 2050, duke ulur emetimet e CO₂, të cilat ndikojnë në mënyrë negative në klimë. Në përgjithësi, është dakorduar që reduktimet më të mëdha të CO₂ mund të arrihen më së miri përmes burimeve të ripërtëritshme

të energjisë dhe efiçencës së energjisë (IRENA 2011-2020). Sipas të dhënave të përmbledhura dhe të analizuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, sasia më e madhe e emetimeve të CO₂ në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kosova) vjen nga prodhimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes, pasuar nga sektori industrial dhe së fundmi nga



sektori i transportit (Komuniteti i Energjisë 2020, fq.7). Megjithatë, tranzicioni energjetik nuk është një koncept i thjeshtë, i cili zakonisht konsiderohet vetëm si një kalim nga lëndët djegëse fosile në burime të ripërtëritshme. Përkundrazi, ky tranzicion energjetik përfshinë një proces kompleks, me një sërë komponentësh dhe nxitësish, ashtu siç shpjegohet në Kapitullin e tretë. Sidoqoftë, një gjë është e sigurt, se burimet e ripërtëritshme, së bashku me një pjesëmarrje aktive të konsumatorëve final, mund të ndihmojnë në mënyrë pozitive në tranzicionin energjetik në çdo vend,

përfshirë këtu edhe Kosovën.

Në tetor të vitit 2005, Kosova nënshkroi marrëveshjen e traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe si palë kontraktuese është ligjërisht e detyruar nga Acquis e Komunitetit të Energjisë, krahas tjerash, që të sigurojë dhe implementojë burime të ripërtëritshme të energjisë (tash e tutje: BRE-të), përmes kornizës ligjore në fuqi dhe të ndihmojë në inkuadrimin e BRE-ve në treg (Komuniteti i Energjisë 2020b). Si pjesë e Komunitetit të Energjisë, Kosova ka marrë përsipër një objektiv të detyrueshëm në konsumin përfundimtar bruto të energjisë deri në vitin 2020, i cili zbërthehet më tej në objektivat e energjisë, ngrohjes dhe ftohjes dhe të sektorëve të transportit (Republika e Kosovës 2013, fq.14). Fokusi i këtij studimi vendoset tek BRE-të e vogla, në mënyrë specifike tek impiantet që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (tash e tutje: PE-BRE) dhe potencialet

“...synojë ta dekarbonizojnë sektorin energjetik me zero-karbon deri në vitin 2050...”



e tyre për të avancuar tranzicionin energjetik në Kosovë. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet barrierave aktuale që pengojnë zhvillimin e impianteve të BRE-ve të vogla, duke e zvarritur kështu tranzicionin energjetik në Kosovë.

2. METODOLOGJIA

Kjo pjesë përcakton qasjen metodologjike që është aplikuar për të marrë përsipër këtë studim hulumtues, duke përfshirë metodat për grumbullimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë kontributin e mundshëm të BRE-ve të vogla në aspektin e tranzicionit energjetik në Kosovë. Për të arritur këtë qëllim, është zhvilluar një hulumtim cilësor me fokus në barrierat me të cilat përballet komuniteti i bizneseve në zhvillimin, instalimin dhe funksionimin e projekteve të vogla të BRE-ve.

Gjithashtu, është analizuar vlerësimi i masave kombëtare mbi promovimin e BRE-ve. Është përzgjedhur hulumtimi cilësor për arsye se mundëson përpilimin e pyetjeve dhe procedurave të paraqitura, prej ku në mënyrë a posteriori (duke gjykuar nga pasojat) zhvillohet analiza e të dhënave, duke u zhvendosur nga temat e veçanta



në ato të përgjithshme, teksa realizohet edhe interpretimi i të dhënave (Creswell 2014, fq.32).

Përmes prezantimit dhe analizës së barrierave me të cilat përballet komuniteti i bizneseve që kanë të bëjnë me BRE-të në Kosovë, ky hulumtim do t'u përgjigjet pyetjeve të identifikuar në Termat e Referencës, teksa gjithashtu do të nxjerr në pah çështjet kryesore që duhet të përshtaten apo të rregullohen nga Kosova, për ta ndihmuar në tranzicionin e saj energjetik, i cili, krahas tjerash, përfshin një rritje në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe fuqizimin e konsumatorëve final.

Është grumbulluar informacion i hollësishëm duke aplikuar pyetësorët, intervistat, studimet e legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe një sërë burimesh dytësore. Hulumtimi kontribuon në literaturën ekzistuese mbi gjendjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë, duke identifikuar disa barrierat e cilat

duhet të mënjahen, për t'ua mundësuar kategorive të caktuara të projekteve të BRE-ve të avancojnë, e të cilat do të kontribuonin pozitivisht në aspektin e tranzicionit energjetik.

Është aplikuar analiza a posteriori (duke gjykuar nga pasojat) dhe ajo a priori (nga shkakut e pasojave) i të dhënave gjatë procesit të këtij studimi. Sipas Creswell (2014, fq.234):

Hulumtuesit cilësorë i krijojnë modelet, kategoritë dhe temat përmes qasjes poshtë-lart, duke i organizuar të dhënat në njësi gjithnjë e më abstrakte të informacionit. Ky proces a posteriori sqaron ndërveprimin midis temave dhe databazës, derisa hulumtuesit të kenë krijuar një kategori gjithëpërmbledhëse të temave. Pastaj, përmes metodës a priori, hulumtuesit shqyrtojnë përsëri të dhënat e tyre nga temat, për të përcaktuar nëse nevojiten më shumë evidenca që mund të mbështesin secilën temë apo nëse duhet të grumbullojnë informata shtesë. Si rrjedhojë, teksa procesi fillon në mënyrë a posteriori, të gjykuarit përmes mënyrës a priori gjithashtu luan rol të rëndësishëm, ndërsa analiza është duke avancuar.

Përmasa e grupit të pjesëmarrësve për hulumtimin aktual ishte e kufizuar në dhjetë (10) kompani, që si aktivitet kanë instalimin dhe zhvillimin e sistemeve të paneleve solare fotovoltaike, të cilat si rrjedhojë përfshijnë projektet e vogla të BRE-ve në Kosovë. Kompanitë u identifikuan përmes mjeteve publike në dispozicion, të tilla si ueb-faqet e tyre, regjistri i

bizneseve të regjistruara në Kosovë, si dhe anëtarësitë nëpër shoqatat biznesore. Përmes aplikimit të pyetjeve gjysëm të strukturuar dhe atyre të pastrukturuar, pjesëmarrësit pritët të shprehin mendimin e tyre të lirë duke shkëmbyer kështu të dhëna të besueshme, të krahasueshme dhe cilësore.

Janë zhvilluar disa takime dhe komunikime online me dy organizata, Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare dhe Kllasteri i Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtërueshme të Kosovës (KIMERK), të cilat siguruan një sërë dokumentesh të papublikuara që kishin të bënin me barrierat me të cilat përballet komuniteti i bizneseve në ndërmarrjen e projekteve të BRE-ve të vogla. Këto të fundit ofruan gjithashtu informata me shkrim në lidhje me çështjet tjera, siç janë kapacitetet e disponueshme për projektet e paneleve solare fotovoltaike. Poashtu, u zhvillua një takim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, si institucioni kryesor kombëtar, sa i përket kornizës rregullative për projektet e vogla të BRE-ve. Së fundi, një ekspert i energjisë, në kushte anonime ka ofruar informata rreth vështirimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSh), i cili trajton aplikacionet e konsumatorëve-prodhues. Eksperti u përzgjodh për intervistë duke u bazuar në përvojën dhe njohuritë e hollësishme rreth mekanizmit të akterëve relevant dhe pjesëmarrësve në treg.

¹ Ju lutemi shikoni Shtojcën 1.

3. TRANZICIONI I SEKTORIT TË ENERGJISË NË EVROPË DHE PROGRESI I KOSOVËS NË KËTË DREJTIM

Ashtu sikurse vihet në dukje nga Fattouh et al. (2019, fq.46), tranzicioni energjetik është më tepër një proces kompleks sesa thjesht një zëvendësim i një burimi të energjisë me një tjetër, kështu, kjo kërkon ndryshime shumëdimensionale që përfshijnë teknologjinë, infrastrukturën, modelet e kërkesës dhe furnizimit, kornizën ligjore dhe rregullative, shoqërinë dhe mënyrën e sjelljes së akterëve të ndryshëm, siç janë strategjitë e investimeve. Kjo qasje komplekse shumëdimensionale e tranzicionit energjetik mund të ilustruhet në mënyrë praktike nga “Tranzicioni Energjetik i Gjermanisë”, i njohur gjithashtu si “Gjelbërimi i përhershëm”, i cili synon të garantojë sigurinë e furnizimit përmes shfrytëzimit të burimeve të qëndrueshme të energjisë, që janë praktike nga aspekti ekonomik dhe që kanë qasje miqësore ndaj mjedisit, duke zvogëluar në të njëjtën kohë emetimet e gazrave serrë për të arritur një ekonomi me zero karbon. Me fjalë të tjera, kjo nënkupton largimin nga lëndët djegëse fosile dhe përqendrimin tek energjitë e ripërtëritshme, rritja e efikasitetit të energjisë, përdorimi i teknologjive të ruajtjes së energjisë, kombinimi i sektorëve dhe transformimi i furnizimit aktual të energjisë elektrike, duke pasur

si qëllim strukturat e decentralizuara, siç janë rrjetet inteligjente (Ministria Federale e Edukimit dhe Hulumtimit). Në mënyrë vendimtare, komponenti kryesor i tranzicionit energjetik në mbarë botën është shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Në nivel global, promovimi fillestar i BRE-ve filloi në vitet e 70-ta, si rezultat i krizës së naftës, që ngriti shqetësime në lidhje me sigurinë e furnizimit dhe shfrytëzimin e burimeve në vend.



Atëkohë, teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme nuk ishin aq të zhvilluara sa janë sot, ndërsa dominonin teknologjitë konvencionale, gjithashtu për shkak të subvencionimit të plotë nga qeveritë. Sidoqoftë, Gjermania, vendet Nordike dhe Holanda filluan të investonin në hulumtimin dhe zhvillimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme (Govori 2017, fq.2). Në nivel të komunitetit,² teknologjitë e ripërtëritshme filluan të promovoheshin përmes programeve demonstruese, kurse më vonë përmes zhvillimit të planeve strategjike dhe akteve legislative. Nismat konkrete për promovimin e BRE-ve në nivel të komunitetit përfshinin Rezolutën e Këshillit të vitit 1986, i cili si objektiv të energjisë përcaktoi zhvillimin e BRE-ve, duke rritur prodhimin e BRE-ve. Kjo u pasua nga programet, të tilla si JOULE, THERMIE, INCO, FAIR dhe Plani Strategjik i Teknologjisë Energjetike, duke përfshirë programin e parë të mbështetjes financiare, ALTENER, për promovimin e BRE-ve (Govori 2017, fq.2-3). Megjithatë, dokumenti më i rëndësishëm strategjik i cili ia mundësoi BRE-ve inkuadrimit në treg, duke kontribuar kështu në konceptin e sotëm të tranzicionit energjetik (të pastër), ishte Dokumenti i Gjellbër i Komisionit Evropian i vitit 1996, i cili propozoi një objektiv domethënës të Bashkimit Evropian (BE) prej 12% nga burimet e ripërtëritshme të konsumit final të energjisë deri në vitin 2010 (Govori 2017, fq.3). Si rrjedhojë, në vitin 2001 dhe 2003, BE-ja prezantoi një nga dy direktivat për BRE-të, pasuar nga direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme e

**“ ..të paktën
55% në
reduktimin e
emetimeve të
gazrave serrë,
deri në vitin
2030...”**

vitit 2009, e cila përmban një objektiv të detyrueshëm (Govori 2017, fq.4-6). Viti 2009 mund të konsiderohet si vendimtar, i cili rifuqizoi angazhimin për të implementuar tranzicionin energjetik përmes objektivave të detyrueshme fillestare prej 20% për BRE-të, eficiencës së energjisë dhe reduktimeve të emetimeve të gazrave serrë.

Sikurse u përshkrua në paragrafët e mësipërm, tranzicioni energjetik është një proces i cili është në vazhdim e sipër në mbarë botën. Sa i përket BE-së, në vitin 2015 u realizua një nismë vendimtare për të nxitur tranzicionin energjetik, kur Komisioni Evropian (tash e tutje: Komisioni) miratoi Strategjinë Kornizë për Unitet të Energjisë së Qëndrueshme përmes Politikave të Avancuara për Ndryshim të Klimës (Komisioni Evropian 2015). Në nëntor të vitin 2016, Komisioni prezantoi Pakon e Energjisë së Pastër për të gjithë evropianët, që përbëhet nga tetë (8) akte legislative (direktiva dhe rregullore), e cila u miratua në vitin 2018 dhe 2019. Rëndësia e kësaj pakoje është e jashtëzakonshme, meqë fasilton tranzicionin në ekonominë me karbon

² Niveli i komunitetit ka të bëjë me strukturën fillestare zyrtare të BE-së së sotme, i njohur më herët si Komuniteti Ekonomik Evropian dhe më vonë si Komuniteti Evropian, që përfundimisht u zëbërthe në Bashkimin Evropian, në vitin 2009.

zero deri në vitin 2050, implementon zotimet ndaj Marrëveshjes së Parisit për trajtimin e ngrohjes globale dhe krahas tjerash, kjo pako do të sjellë përfitime nga pikëpamja ekonomike dhe do t'i fuqizojë konsumatorët final (Komisioni Evropian 2017). Në shtator të vitit 2020, Komisioni njoftoi se do të propozojë një objektiv të ri të BRE-ve deri në 38-40% në konsumin përfundimtar bruto të energjisë dhe të paktën 55% në reduktimin e emetimeve të gazrave serrë, deri në vitin 2030 (Komisioni Evropian 2020; PV Magazine 2020).

Zotimet e BE-së për tranzicionin energjetik, përveç rritjes së nivelit të efijencës, krijojnë vende të reja të punës, shtojnë sigurinë e energjisë, si dhe ndryshojnë rregullat dhe strukturën e tregut për një përfshirje më të madhe të burimeve të ripërtëritshme, duke ua mundësuar konsumatorëve të luajnë një rol vendimtar drejt tranzicionit. Kjo do të thotë që konsumatorët do të prodhojnë, depozitojnë, konsumojnë dhe të shesin energjinë e tyre elektrike, në mënyrë individuale përmes mbledhësve apo bashkësive të energjisë. Përveç kësaj, konsumatorët do të jenë kompetentë dhe do të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre në lidhje me mënyrën se si e shfrytëzojnë energjinë, duke vëzhguar tarifatat e larta dhe çmimet përkatëse përmes njehsorëve inteligjentë, duke vendosur kështu që të zvogëlojnë kërkesën dhe të shfrytëzojnë energjinë e tyre të prodhuar, ose ta furnizojnë rrjetin inteligjent me atë energji, ku edhe mund të përfitojnë financiarisht (Komisioni Evropian 2019, fq.12-13).

3.1. PROGRESI I KOSOVËS NË ASPEKTIN E TRANZICIONIT ENERJETIK

Veprimin kryesor që Kosova duhet ta ndërmarrë në aspektin e tranzicionit energjetik është ndërprerja graduale e prodhimit të energjisë elektrike përmes shfrytëzimit të lëndëve djegëse fosile, posaçërisht linjtit, për të ndryshuar miksin e saj të energjisë (Komuniteti i Energjisë 2020d, fq.4). Që miksi i lëndëve djegëse (fuel mix) të vlerësohet sa më mirë, është e dobishme të analizohen të dhënat e kërkesës dhe furnizimit në lidhje me energjinë elektrike në Kosovë. Sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), kërkesa vjetore e energjisë për vitin 2020 është planifikuar të jetë 6,404 GWh, ndërsa kapaciteti i gjithëmbarshtëm prodhues është 1,216,06 MW të lëndëve djegëse fosile dhe të burimeve të ripërtëritshme (Zyra e Rregullatorit të Energjisë 2020, fq.6,9). Prodhimi i gjithëmbarshtëm i energjisë elektrike që është i lidhur në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes llogaritet të jetë 6,210.8 GWh. Pjesëmarrje e BRE-ve që aktualisht kontribuojnë në miksin e energjisë është HC Ujmani me 97 GWh, HC-Kaskada e Lumbardhit me 105 GWh dhe Impianti i erës KITKA me 95.5 GWh (tre prej tyre janë të lidhur në rrjetin e transmetimit) dhe 258,6 GWh shtesë nga hidrocentralet e vogla, mullinjtë e erës dhe panelet/impianetet solare fotovoltaike të lidhura me sistemin e shpërndarjes (Zyra e Rregullatorit të Energjisë 2020, fq.7). Ndonëse situata është duke u përmirësuar, furnizimi dhe si rrjedhojë, siguria

energjetike ende varet në masë të madhe nga lëndët djegëse fosile. Të dyja termocentralet që punojnë me linjit prodhojnë 91.04% të energjisë elektrike, ndërsa BRE-të që janë të lidhura në rrjet kontribuojnë me 4.16%, teksa 4.79% prodhohen nga dy hidrocentralet e mëdha dhe një impiant i erës, të cilat janë të lidhura në rrjetin e transmetimit (Zyra e Rregullatorit të Energjisë 2020, fq. 8). Si përmbledhje, vetëm rreth 5-6% e energjisë së gjithëmbarshe elektrike prodhohet nga hidrocentralet e vogla, impiantet e erës dhe atyre solare, prandaj, kjo është një pjesëz shumë e vogël dhe e pamjaftueshme që ndikon negativisht në tranzicionin nga lëndët djegëse fosile në burime të tjera, kryesisht energji të ripërtëritshme.

Kosova ka një objektiv të detyrueshëm, në kuadër të së cilit 25% të BRE-ve duhet të përfshihen në konsumin përfundimtar bruto të energjisë deri në vitin 2020, si dhe një objektiv tjetër vullnetar që përbën 29.47%. Në kuadër



“Kosova ka një objektiv të detyrueshëm, në kuadër të së cilit 25% të BRE-ve duhet të përfshihen në konsumin përfundimtar bruto të energjisë...”

të objektivit të përgjithshëm detyrues, PE-BRE-të duhet të kenë pjesëmarrje prej 14,33%, PE-N&F-BRE-të me 45,65% dhe BRE-T me 10% (Republika e Kosovës 2013, fq. 14,17). Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Raportin e tij Vjetor të Implementimit 2020 (2020a, fq.90), ka nxjerrë në pah se Kosova ishte në rrugën e duhur për ta realizuar objektivin prej 25% të pjesëmarrjes së BRE-ve deri në vitin 2020, mirëpo kjo arritje është realizuar si rezultat i pjesëmarrjes së PE-N-BRE (Prodhuesit e energjisë për ngrohje nga BRE-të), duke përfshirë në përlllogaritje më tepër konsumin e biomasës së energjisë nga konsumatorët rezidentë sesa investimin në energjinë e ripërtëritshme. Për më tepër, i njejtë burim vë në dukje se në vitin 2019, Kosova ka pasur një kapacitet të BRE-ve prej 32 MW nga hidrocentralet e mëdha, 63 MW nga hidrocentralet e vogla, 34 MW nga impianti i erës dhe 10 MW nga panelet solare. Sa i përket BRE-T-ve, pjesëmarrja e tyre vazhdon të mbetet zero (Komuniteti i Energjisë 2020a, fq.90).

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, Kosova do të duhet të negociojë në lidhje me pjesëmarrjen e BRE-ve në kuadër të Komunitetit të Energjisë për periudhën kohore deri në vitin 2030. Si rrjedhojë, një objektiv i arritshëm duhet të prezantohet dhe të mbështetet nga Qeveria e Kosovës. Në studimin e saj hulumtues, Govori (2019, fq. 11), vë në dukje se komuniteti i bizneseve që vepron në sektorin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë është duke avokuar për një objektiv të ri të pjesëmarrjes së BRE-ve prej 35-40% për periudhën kohore deri në vitin 2030. Sidoqoftë, as aktet juridike primare e as ato sekondare të Kosovës nuk kërkojnë drejtpërdrejt pjesëmarrjen e caktuar të BRE-ve të impianteve të vogla, të cilat zakonisht përbëjnë impiantet që shfrytëzohen për vetë-konsum.

Një nxitës i rëndësishëm nga aspekti i tranzicionit energjetik është ridizajnimi i tregut të energjisë elektrike për t'u bërë më konkurrues, për shkak se pjesëmarrja në treg e prodhuesit më të madh të energjisë elektrike (KEK-u) është mbi 90%, ndërsa pjesëmarrja në treg e furnizuesit të energjisë elektrike (KESCO) është 100% (Komuniteti i Energjisë 2020d, fq.5). Prandaj, prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme, duke përfshirë konsumatorët final, duhet të vihen në pozita që sigurojnë pjesëmarrje më të madhe. Siç u theksua më parë, ekziston një sërë komponentesh dhe katalizatorësh në tranzicionin energjetik në mbarë botën, në BE dhe gjithashtu në Kosovë. Megjithatë, në çdo rajon ose vend, energjia e ripërtëritshme dhe fuqizimi i konsumatorëve konsiderohen si nxitësit kryesorë të tranzicionit energjetik. Impiantet e BRE-ve të vogla kanë një rëndësi të madhe në dhënien e kontributit për tranzicionin energjetik në Kosovë. Kjo kategori e impianteve, siç do të shpjegohet në mënyrë të hollësishme në kapitujt e ardhshëm, ka potencialin më të madh, për arsye se barrierat aktuale mund të mënjanoen pa vështirësi, duke mundësuar rritjen e pjesëmarrjes së PE-BRE-ve në treg. Për më tepër, përmes fuqizimit të konsumatorëve final për t'u bërë konsumatorë-prodhues, kjo jo vetëm që do të ndihmojë në realizimin e objektivit ekzistues të BRE-ve, por gjithashtu do ta sistemojë Kosovën në rrugën e duhur për t'u harmonizuar me nismat e BE-së për periudhën kohore deri në vitin 2030.

4. BRE-TË E VOGLA NË KOSOVË

Pakoja e Energjisë së Pastër për të gjithë evropianët, veçanërisht direktivat e korigjuara të energjisë elektrike dhe energjisë së ripërtëritshme, theksojnë rolin e rëndësishëm të konsumatorëve final në tranzicionin energjetik dhe promovimin e rolit aktiv të konsumatorëve dhe vetë-konsumit të ripërtëritshëm (Komisioni i Energjisë 2017). Megjithatë, për të vlerësuar saktë ndikimin e BRE-ve të vogla, duke përfshirë konsumatorët-prodhues në tranzicionin energjetik të Kosovës, është e rëndësishme të shqyrtohet se në ç'mënyrë korniza aktuale ligjore dhe rregullative e përmbledh këtë kategori, sa është ofruar mbështetja kombëtare dhe cili është niveli i zhvillimit të këtyre projekteve të vogla, duke përfshirë konsumatorët-prodhues në Kosovë. Nën-kapitujt e mëposhtëm do të nxjerrin në pah gjendjen aktuale të BRE-ve të vogla, që përmbledhin vetëm impiantet më të vogla ose të barabarta me 100kW, të cilat në praktikë përfshijnë vetëm impiantet e konsumatorëve final.

4.1. KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR NDËRTIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BRE-VE TË VOGLA

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-081 për Energjinë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (ashtu siç dihej), miratoi një udhëzim administrativ në lidhje me shfrytëzimin dhe mbështetjen e BRE-ve (Republika e Kosovës 2017a, neni 4), i cili krahas tjerash parashikon tri kategori të ndryshme të impianteve që prodhojnë energji elektrike nga BRE-të:

Kategoria 1 - impiantet e lidhura në rrjet me kapacitet deri në 100 kW;

Kategoria 2 - impiantet e lidhura në rrjet me kapacitet të instaluar mbi 100 kW, megjithatë me kapacitete prej 35 MW për impiantet e erës; 3MW për panelet solare fotovoltaike; 10 MW për hidrocentrale dhe 14MW për biomasë;

Kategoria 3 - impiantet për të gjitha BRE-të që shfrytëzohen për vetë-konsum.



Në praktikë, kategoria 1 përfshinë të gjithë konsumatorët final të cilët posedojnë statusin e konsumatorit-prodhues, ndërsa në mënyrë teorike gjithashtu përfshinë kapacitetet prodhuese, aktiviteti kryesor i të cilave është shitja e energjisë elektrike, megjithatë, për shkak të kapacitetit prej 100kW impiante të tilla nuk ekzistojnë në Kosovë. Kategoria 2 përfshinë të gjithë prodhuesit e PE-BRE-ve, funksioni kryesor i të cilëve është prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e saj, e që aktualisht përfitojnë nga skema mbështetëse e tarifave nxitëse.³ Kategoria 3 përfshinë të gjithë konsumatorët final që shfrytëzojnë PE-BRE-të për vetë-konsum, por të cilët nuk e bëjnë injektimin e energjisë së tepërt në rrjetin e distribuimit dhe nuk kompenzohen përmes skemave mbështetëse siç janë aktualisht konsumatorët-prodhues. Për shkak të faktit që kategoritë 1 dhe 2 në mënyrë specifike nxjerrin në pah lidhjen me rrjetin, ndërsa kategoria 3 nuk e bën një gjë të tillë, kjo automatikisht lë të kuptojë interpretimin e mësipërm dhe ndarjen e vetë-konsumit midis impianteve që janë të lidhura me rrjetin dhe ato që nuk janë të lidhura me rrjetin, që do të thotë se këta të fundit nuk e bëjnë injektimin e energjisë elektrike në rrjetin e distribuimit. Kjo mbështetet gjithashtu nga ZRrE-ja, përmes së cilës përfaqësuesit e saj theksuan që impiantet e vetë-konsumit të cilat nuk përfshihen në rrjetin e distribuimit, nuk kanë ndonjë detyrim ligjor për autorizim, meqë korniza ekzistuese ligjore dhe rregullative nuk parashikon ndonjë detyrim ligjor për autorizim, meqë korniza ekzistuese ligjore dhe rregullative nuk parashikon

ndonjë detyrim, prandaj ato llogariten si impiante jashtë rrjetit të distribuimit.

Një përkufizim i qartë rreth asaj se çfarë konsiderohet si impiant i vogël i BRE-ve ofrohet në Rregulloren e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (Republika e Kosovës 2017b, neni 3, paragrafi 1.12), i cili nënvizon se vetëm impiantet deri në 100kW, të cilat janë të lidhura me rrjetin e distribuimit llogariten si impiante të vogla, ndërsa të gjitha impiantet tjera mbi këtë kapacitet konsiderohen si kapacitete të mëdha prodhuese. Sikurse u përmend në paragrafin e dytë të këtij nën-kapitulli, ekzistojnë dy skenarë të ndryshëm të BRE-ve të vogla që prodhojnë kapacitete të energjisë. Njëri skenar është atëherë kur impianti

“...impiantet deri në 100kW, të cilat janë të lidhura me rrjetin e distribuimit llogariten si impiante të vogla...”

³Tarifa nxitëse është e vetmja skemë mbështetëse që aplikohet për impiantet prodhuese të BRE-ve. Në korrik të vitit 2019, BERZH ka pranuar një kërkesë nga Qeveria e Kosovës për ta ndihmuar në hartimin dhe implementimin e skemës së ankandit.

prodhues është ndërtuar për qëllimin kryesor të prodhimit dhe shitjes së energjisë elektrike, ndërsa skenari i dytë është atëherë kur një konsumator final prodhon energji elektrike nga impianti i vet, e konsumon atë dhe pastaj energjinë e tepërt e injekton në rrjetin e distribuimit.

Për grupin e parë të impianteve për prodhimin e BRE-ve të vogla, ekziston një kërkesë për autorizim, ndërsa rregullatori kombëtar lëshon një autorizim paraprak dhe përfundimtar (Republika e Kosovës 2017b, nenet 5-7). Sidoqoftë, nga ky grup i impianteve për prodhimin e BRE-ve të vogla nuk kërkohet pajisja me licensë për prodhim, meqë kjo kërkohet vetëm për kapacitetet mbi 5 MW (Republika e Kosovës 2017b, neni 18). Që nga 18 nëntori 2020, nuk kishte asnjë aplikacion në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për ndonjë kapacitet prodhues më të vogël ose të barabartë me 100kW.⁴

Sa i përket impianteve të BRE-ve të vogla që shfrytëzohen për vetë-konsum, procedura është më e thjeshtë. Gjatë paraqitjes së dokumenteve: personi juridik ose fizik duhet të paraqesë pranë ZRrE-së një kërkesë me shkrim duke ofruar dëshmitë si në vijim: 1) dëshmia nga KEDS (OSSH) rreth konsumit vjetor të energjisë; 2) vlerësimi për prodhimin vjetor të pajisjes së instaluar (në kWh); 3) pëlqimi për lidhje në rrjetin e distribuimit, të lëshuar nga KEDS dhe; 4) pëlqimi nga komuna përkatëse (Republika e Kosovës 2017b, neni 25).

Vlen të përmendet se impiantet e BRE-ve të vogla që shfrytëzohen për vetë-konsum, të cilat nuk injektojnë energji elektrike në rrjetin e distribuimit, aktualisht nuk kanë ndonjë obligim ligjor për ta informuar Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe as që janë të detyruar të pajisen me ndonjë autorizim, siç është shpjeguar më lart për dy kategoritë tjera. Kërkesat për autorizim vlejné vetëm për impiantet e vogla, për të cilat kërkohet statusi i konsumatorëve-prodhues, që nënkupton se ato impiante do të injektojnë energjinë e tepërt në rrjetin e distribuimit. Kjo procedurë është konfirmuar edhe gjatë takimit të zhvilluar me përfaqësuesit e ZRrE-së më 9 nëntor 2020. Sidoqoftë, meqë është një kërkesë për prodhuesit e vetë-konsumit, të cilët janë të inkuadruar në rrjetin e distribuimit, edhe prodhuesit e vetë-konsumit të cilët nuk e injektojnë energjinë elektrike në rrjetin e distribuimit duhet të marrin pëlqimin nga komuna për të instaluar në kulm sistemet e paneleve solare fotovoltaike, kryesisht për arsye sigurie dhe për të parandaluar ndonjë aksident të mundshëm. Sidoqoftë, siç konfirmohet përmes intervistave të zhvilluara me komunitetin e bizneseve, ky pëlqim, në shumicën e rasteve nuk vlen për impiantet që operojné jashtë rrjetit të distribuimit.

Duke pasur parasysh që aktualisht në Kosovë nuk ka kapacitete prodhuese të BRE-ve të vogla, të cilat si aktivitet të tyre kryesor kanë prodhimin e energjisë elektrike, nën-seksionet pasuese do të përqendrohen në gjendjen e impianteve të BRE-ve të vogla, që përdoren për vetë-konsum, me fokus tek ato që injektojnë energjinë e tyre të tepërt në rrjetin e distribuimit.

⁴Kapaciteti prodhues më i vogël i BRE-ve, aktiviteti kryesor i të cilave është shitja e energjisë elektrike, është 0.102MW, i cili megjithëse është shumë pak, prapëseprapë e tejkalon kapacitetin prej 100kW.

4.2. VETË-KONSUMI I BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË NGA IMPIANTET QË JANË TË INKUADRUARA NË RRJETIN E DISTRIBUIMIT

Duke marrë në konsideratë kornizën kombëtare ligjore dhe rregullative, ekziston një referencë për vetë-konsum të energjisë, e cila megjithatë përmban kufizime. Ligji për Rregullatorin e Energjisë kërkon që Zyra e Rregullatorit të Energjisë të miratojë rregullore në lidhje me prodhimin e vogël dhe të decentralizuar dhe/ose të shpërndarë të energjisë, megjithatë këto nuk janë të shtjelluara (Republika e Kosovës 2016, neni 43.4), edhe pse në Nenin 2 të Rregullores mbi skemën mbështetëse për prodhuesit e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë ekziston një referencë në lidhje me konceptin e konsumatorit-prodhues dhe prodhuesve të vetë-konsumit (Republika e Kosovës 2017c, paragrafët 1.9, 1.18):

Konsumatori-prodhues – është një konsumator i energjisë elektrike, që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend është pronar i impiantit prodhues të një BRE-je të vogël, i cili është i lidhur me rrjetin e distribuimit dhe që ka të drejtë të vetë-konsumojë energjinë e prodhuar elektrike, si dhe të injektojë energjinë e tepërt elektrike tek furnizuesi;

Prodhuesit e vetë-konsumit – janë konsumatorët-prodhues, të cilët janë në gjendje të bëjnë furnizimin e tepërcës së energjisë së prodhuar elektrike në rrjetin e distribuimit për konsumim të mëtutjeshëm ose ta paguajnë furnizuesin për energjinë e konsumuar elektrike në rast të bilancit negativ.

I njëjti rregull vlen për të kufizuar statusin e konsumatorit-prodhues në aspektin e impianteve të BRE-ve të vogla, me një kapacitet deri në 100kW, ndërsa të gjitha impiantet tjera mbi këtë kapacitet konsiderohen si impiante të mëdha të BRE-ve (Republika e Kosovës 2017c, neni 2 paragrafi 1.7). Përveç kësaj, të gjithë konsumatorët final që dëshirojnë të bëhen konsumatorë-prodhues, duhet të jenë të lidhur në rrjetin e distribuimit me tension të ulët (Republika e Kosovës 2017c, neni 20.). Nëse shqyrtohen kufizimet që ekzistojnë nëpër vendet tjera, mund të vërehet se kapaciteti i prodhuesve të BRE-ve të vogla dallon midis palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, duke filluar prej 2 kW deri në 10 MW (Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë 2020, fq.17-18). Madje edhe në mesin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ekziston një mori përkufizimesh në lidhje me vetë-konsumin dhe grupet e konsumatorëve-prodhues, prandaj është propozuar që të ketë një ndarje të konsumatorëve-prodhues, ku impiantet që kanë kapacitet më të vogël ose të barabartë me 10 kW mund të jenë konsumatorë-prodhues rezidentë; ata me kapacitet ndërmjet 10 deri 250 kW mund të shërbejnë si konsumatorë-prodhues komercial dhe çdo impiant që ka kapacitet mbi 250 kW mund të konsiderohet si konsumator-prodhues industrial (konsorciumi GfK Belgium 2017, fq.19).

Sikurse u përmend më herët, korniza ligjore dhe rregullative e Kosovës lejon statusin e

konsumatorit-prodhues vetëm për impiantet deri në 100kW, pa bërë ndonjë dallim ndërmjet konsumatorëve-prodhues rezidentë ose komercial. Nëse i referohemi regjistrit të ZRrE-së për kapacitetet e vetë-konsumit, deri me 18 nëntor 2020, Rregullatori ka autorizuar gjithsej 1,527.91 kW dhe vetëm një (1) është në pritje të autorizimit. Midis pesëdhjetë (50) autorizimeve të lëshuara, njëzet e dy (22) janë për persona fizikë, një (1) për një komunë, një (1) për OJQ dhe pjesa tjetër prej njëzet e gjashtë (26) janë për biznese. Figura 1 në vijim paraqet numrin e autorizimeve dhe kapacitetin e instaluar për secilën kategori të konsumatorëve-prodhues.

GJENERUESIT E AUTORIZUAR PËR VETË-KONSUM




Figura 1: Projektet e autorizuar të PE-BRE-ve të vogla për vetë-konsum (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e regjistrit të ZRrE-së mbi aplikacionet për prodhuesit për qëllime të vetë-konsumit)

4.3. SKEMAT MBËSHTETËSE PËR IMPIANTET E BRE-VE TË VOGLA PËR VETË-KONSUM QË JANË TË INTEGRUARA NË RRJET

Siç u shpjegua më lartë, të gjitha impiantet e BRE-ve të vogla për vetë-konsum, të integruara në rrjet, duhet së pari të marrin autorizimin për ndërtimin e implantit. Pasi të ketë siguruar të gjitha dëshmitë dokumentare, siç kërkohet nga Rregullorja e Autorizimit, konsumatori final mund të kërkojë nga furnizuesi i tij (aktualisht KESCO) që të njihet si konsumator-prodhues. Më pastaj, furnizuesi e njofton OSSh-në, teksa ky i fundit duhet të hartojë kushtet e lidhjes në rrjet, duke përfshirë kërkesat për matje, një procedurë që parashikohet të përfundojë brenda 20 ditëve (Republika e Kosovës 2017c, neni 20). Në fund, pas dakordimit për pranimin teknik të lidhjes në rrjet, nënshkruhet marrëveshja me konsumatorin-prodhues (Republika e Kosovës 2017c, neni 20). Në nenin 20, paragrafi 5 i Rregullores përcaktohet një kërkesë mjaft e rëndësishme ku OSSh-ja ngarkohet për të ndryshuar çfarëdo legjislacioni që është në përputhje me Rregulloren (Republika e Kosovës 2017c). Sidoqoftë, siç është vërejtur edhe në studimet tjera, OSSh-ja nuk i ka

zbatuar ndryshimet e kërkuara dhe as nuk ekziston ndonjë informacion në ueb-faqen e OSSh-së për mënyrën se si një konsumator mund të bëhet konsumator-prodhues (Govori 2019, fq. 29). Situata, gati dy vjet më vonë, vazhdon të mbetet e njëjtë, që është konfirmuar edhe nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Si skemë mbështetëse për konsumatorët, Kosova aplikon konceptin net-metering, përmes së cilit konsumatori final injekton energjinë e tepërt elektrike në rrjetin e distribuimit dhe pranon nga furnizuesi energji elektrike shtesë, nëse impianti i tij i BRE-së nuk prodhon sa duhet energji elektrike për vetë-konsum në baza mujore. Në rast se injektohet më tepër energji elektrike sesa pranohet nga rrjeti i distribuimit, atëherë konsumatori kreditohet me kWh në muajin pasues, megjithatë, në rast se bilanci është negativ, atëherë bilanci shpërndahet ndërmjet periudhës së tarifës së lartë dhe të ulët, në pajtueshmëri me konsumin e konsumatorit-prodhues që realizohet në atë muaj specifik. Në rast se bilanci në fund të vitit është pozitiv, nuk realizohet ndonjë transfer për vitin e ardhshëm dhe bilanci nga viti i ardhshëm fillon me zero kWh (Republika e Kosovës 2017c, neni 18-19).

Komuniteti i Energjisë, bazuar në direktivat dhe udhëzimet e reja të BRE-ve dhe të tregut të energjisë elektrike, propozon që koncepti net-metering të ofrohet vetëm për impiantet e vogla me kapacitet deri në 30kW, për një periudhë të kufizuar, pas së cilës konsumatori final duhet të kalojë në një skemë tjetër, me llogari të veçuarë për konsumin e energjisë elektrike nga rrjeti i distribuimit dhe për injektimin e energjisë elektrike në rrjet. Sidoqoftë, në përgjithësi, sistemi më i preferuar për vetë-konsum të vogël të energjisë së ripërtëritshme është tarifa nxitëse (Komuniteti i Energjisë 2020c, fq.9).

Në nivel të BE-së, skemat mbështetëse janë dëshmuar të jenë gjithmonë problematike, duke ia vështirësuar punën Komisionit për të paraqitur një mekanizëm të vetëm ose një kombinim të mekanizmave për shumë vite dhe duke mundësuar zbatim të njëtrajtshëm anembanë shteteve anëtare të BE-së. E njëjta gjë vlen edhe për konsumatorët-prodhues, si rrjedhojë, shtetet e ndryshme anëtare të BE-së aplikojnë skema të ndryshme mbështetëse, duke përfshirë tarifatat nxitëse, bonuset, konceptin net-metering dhe net-balancing, lirimin nga TVSH-ja, subvencionet e kapitalit, kreditë dhe format tjera të mbështetjes së investimeve (konsorciumi GfK Belgium 2017, fq.1, 65-66). Problemet shqetësuese që kanë të bëjnë me konceptin net-metering qëndrojnë tek fakti se rrjeti i distribuimit shfrytëzohet falas si një mjet për depozitim, teksa konsumatorët tjerë të cilët nuk e injektojnë energjinë elektrike në rrjet marrin përsipër shpenzimet e rrjetit dhe taksat tjera të atyre që e injektojnë energjinë elektrike në rrjet. Net-metering konsiderohet të ndikojë negativisht në menaxhimin e pjesës së kërkesës, pasi që konsumatorët-prodhues nuk e rrisin në mënyrë maksimale vetë-konsumin e tyre, nuk e rregullojnë kohën e shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe nuk instalojnë teknologjitë për depozitim, për aq kohë sa kompenzohen në kWh (Komuniteti i Energjisë 2020c, fq.9,11).

4.4. POTENCIALI I ARDHSHËM I SISTEMEVE SOLARE FOTOVOLTAIKE

Siç paraqitet në Figurën 1, në rrjetin e distribuimit ekziston pak më shumë se 1.5 MW kapacitet të instaluar të sistemeve solare fotovoltaike. Është e vështirë të dihet sasia/numri i saktë i impianteve jashtë rrjetit të distribuimit, meqë nuk ka ndonjë autoritet kombëtar i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e statistikave të tilla, ndërsa të dhënat grumbullohen nga subjekte të ndryshme. Për shembull, që nga vitit 2014, Ministria e Bujqësisë është duke ndarë grante të investimeve për fermerët dhe kompanitë e përpunimit të ushqimit në Kosovë, ku përqindja e grantit ishte shpërndarë tek sistemet solare fotovoltaike. Në vitin 2014 u instaluan 79 kW, ndërsa në vitin 2015 u instalua një kapacitet prej 364 kW (Republika e Kosovës, fq.6). Megjithatë, deri në vitin 2020, në ueb-faqen e Ministrisë së Bujqësisë apo të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që është përgjegjëse për implementimin e skemave të granteve, nuk ka në dispozicion të dhëna specifike të grumbulluara. Përmes pyetësorëve dhe intervistave me komunitetin e bizneseve, u nxorr në pah se ekzistojnë pak më shumë se 6 MW të kapacitetit solar të instaluar në impiantet që nuk janë të inkuadruara në rrjet dhe që kanë zero eksport. Megjithatë, pavarësisht vështirësive me statistikën rreth kapacitetit tashmë të instaluar, që nuk injektin energji elektrike në rrjetin e distribuimit, ekzistojnë të dhëna në lidhje me potencialin e ardhshëm të impianteve të BRE-ve të vegjël. Sa i përket potencialit për vetë-konsum, KIMERK-u thekson se sektori i biznesit ka një potencial prej 150 MW, sektori i amvisërisë 50 MW dhe institucionet publike rreth 20-40 MW (2020a). Për më tepër, Figura 2 në vijim tregon potencialin e energjisë fotovoltaike për secilin rajon në Kosovë, që paraqet një potencial shumë të mirë të energjisë fotovoltaike në shumë rajone të Kosovës, të cilat do të shfrytëzohen së shpejti.




Figura 2: Potenciali i energjisë fotovoltaike: Kosovë (Banka Botërore 2019b).

Figura 3 në vijim paraqet rrezatimin global në rrafshin horizontal për secilin rajon në Kosovë, që është një element vendimtar për vlerësimin e paneleve të rrafshta fotovoltaike, si në aspektin e performancës ashtu edhe në kalkulimin e rendimentit të energjisë.




Figure 3: Global Horizontal Irradiation: Kosovo (World Bank 2019a)

Duke marrë parasysh që Kosova gjendet në një pozitë më të mirë se shumë shtete anëtare të BE-së, të cilat sa i përket potencialit të energjisë solare fotovoltaike dhe rrezatimit, aktualisht kanë një pjesëmarrje më të madhe të BRE-ve, e duke qenë se BRE-të e vogla, përfshirë edhe konsumatorët-prodhues kanë një pjesëmarrje shumë modeste në miksin e energjisë, është më se e qartë se kjo kategori, me pak nxitje rregullative dhe financiare, mund të kishte ndikim të drejtpërdrejtë ndaj tranzicionit energjetik, për arsye se do të ndihmonte në realizimin e objektivit të PE-BRE-ve, do të zgjeronte miksin e energjisë përmes burimeve vendore dhe të qëndrueshme, si dhe do t'u krijonte mundësi konsumatorëve final të bëhen pjesëmarrës aktivë në sektorin e energjisë.

Duke pasur në dispozicion të gjitha këto përfitime nga BRE-të e vogla, veçanërisht nga konsumatorët-prodhues, me të drejtë mund të pyesim veten pse Kosova posedon vetëm 1.5 MW kapacitet të instaluar në impiantet e konsumatorëve-prodhues. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, në vijim do të ofrohet një shpjegim i hollësishëm rreth barrierave aktuale që parandalojnë inkuadrimin e mëtejshëm në treg të projekteve të vogla të BRE-ve.

5. BARRIERAT ME TË CILAT PËRBALLEN ZHVILLUESIT E BRE-VE TË VOGLA

Ekziston një sërë barrierash të BRE-ve me të cilat përballet komuniteti i bizneseve që vepron në Kosovë, qoftë në zhvillimin dhe instalimin e projekteve të vogla të BRE-ve, apo në synimin për t'u bërë konsumator-prodhues. Sa i përket barrierave me të cilat përballet, komuniteti i bizneseve në Kosovë ka mbetur i zhurmshëm ndaj autoriteteve përkatëse kombëtare duke kërkuar përshtatje të menjëhershme rregullative dhe ligjore, për të krijuar mundësitë e zhvillimit të projekteve të vogla të BRE-ve dhe për të promovuar dhe ndihmuar inkuadrimin e tyre në treg. Për t'i kuptuar më mirë barrierat, janë grumbulluar informatat përmes tri burimeve themelore, kryesisht për shkak të faktit që ata janë akterë të rëndësishëm të sektorit, teksa mundësojnë një kontroll të tërthortë dhe qasje gjithëpërmblendhëse: 1) Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare; 2) Kllasteri i Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës; dhe 3) Bizneset individuale që veprojnë si zhvillues dhe/ose instalues të paneleve solare fotovoltaike. Barrierat e paraqitura nga burimet e lartpërmendura do të vlerësohen duke marrë parasysh rekomandimet e ofurara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbi integrimin e konsumatorëve që energjinë e ripërtëritshme e shfrytëzojnë për vetë-konsum.



5.1. BARRIERAT LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Sikurse është përmendur në kapitullin e mësipërm, në legjislacionin primar nuk ekziston asnjë referencë në lidhje me konceptin e vetë-konsumit të energjisë së ripërtëritshme. Koncepti dhe përkufizimi i kësaj kategorie të konsumatorëve ofrohet në mënyrë të paplotë vetëm tek dy Rregulloret e ZRrE-së, për shkak se përmbledh vetëm konsumatorët shtëpiak dhe bizneset e vogla komerciale. Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë rregullore që përcakton në mënyrë specifike vetë-konsumin e energjisë së ripërtëritshme. Duke marrë parasysh që “Pakoja e Energjisë së Pastër për të gjithë evropianët” përfshinë një sërë korigjimesh të direktivave dhe rregulloreve, të cilat Kosova do të duhej t’i integronte në ligjin e vet kombëtar deri në vitin 2030, është me rëndësi jetike që legjislacioni primar të harmonizohet me kornizën ligjore të BE-së dhe me udhëzimet e parashikuara nga Komuniteti i Energjisë. Kjo nënkupton se “të gjithë konsumatorët final, pa diskriminim, duhet të kenë të drejtë të bëhen vetë-konsumues të energjisë së ripërtëritshme, qoftë në mënyrë të pavarur ose përmes mbledhësve, apo bashkërisht si vetë-konsumues në kuadër të së njëjtit objekt ose blloqeve të ndërtesave” (Komuniteti i Energjisë 2020c, fq.5).

Barriera kryesore e identifikuar nga komuniteti i bizneseve është kufizimi që vetëm impiantet prodhuese të BRE-ve të vogla mund të bëhen konsumatorë-prodhues, posaçërisht impiantet prodhuese që kanë kapacitet total deri në 100kW dhe që janë të lidhura me 0.4kV (rrjeti i distribuimit me tension të ulët). Si rrjedhojë, siç qëndrojnë aktualisht gjërat, vetëm sektori i amvisërisë dhe bizneset e vogla mund të aplikojnë për t’u bërë konsumatorë-prodhues. Sidoqoftë, kjo lë mënjanë një numër të madh konsumatorësh potencial, që mund (dhe duhet) të bëhen konsumatorë-prodhues, duke iu referuar veçanërisht bizneseve më të mëdha, të tilla si ato që janë të angazhuara në sektorin e prodhimit. Ky lloj i konsumatorit ka nevojë për një kapacitet më të madh, në mënyrë që të shfrytëzohet si duhet kulmi i tij me sipërfaqe të gjerë dhe të bëhet një investim tërheqës nga aspekti financiar, pasi që sa më i madh të jetë kapaciteti i instaluar aq më e ulët është kostoja/njësia e investimit, që mundëson një kthim më të shpejtë të investimit. Për aq kohë sa kërkohet mënjanimi i kapacitetit të instaluar, duhet të anulohet edhe kërkesa për lidhje në rrjetin e distribuimit me tension të ulët, duke ua mundësuar në këtë mënyrë konsumatorëve të lidhen në rrjetin me tension të mesëm (10kV dhe 35kV), për të përfituar nga statusi i konsumatorëve-prodhues (Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare 2020b, fq.1; KIMERK 2020b, fq. 1-2)

Barriera e lartpërmendur është e lidhur ngushtë me faktin se ekziston një mungesë e përkufizimeve të duhura për secilën kategori potenciale të konsumatorëve-prodhues të ardhshëm. Pra, rregulloret e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ua mundësojnë vetëm projekteve të vogla të BRE-ve të fitojnë statusin e konsumatorëve-prodhues. Rrjedhimisht, për aq kohë sa sektori i amvisërisë nuk veçohet siç duhet nga kategoritë e

bizneseve, siç janë bizneset e vogla/të mesme dhe bizneset e mëdha/industriale, atëherë, kategorisë së fundit nuk do t'i garantohet e drejta për të prodhuar, konsumuar dhe injektuar energjinë e tepërt në rrjetin e distribuimit. Për më tepër, Komuniteti i Energjisë rekomandon mënjanimin e barrierave të tilla teknike, teksa të gjithë konsumatorëve final që posedojnë impiante për vetë-konsum të energjisë së ripërtëritshme duhet t'u lejohet lidhja në të gjitha nivelet e tensionit, pa ndonjë kapacitet të propozuar të impiantit, megjithatë, konsumatorët që përfitojnë nga skemat mbështetëse nuk duhet ta tejkalojnë kapacitetin e kërkuar të lidhjes në rrjet (Komuniteti i Energjisë 2020c, fq. 7).

Rrjedhimisht, këto barrierat teknike të identifikuar më lartë duhet të merren parasysh gjatë hartimit të kornizës ligjore dhe rregullative, për të qenë në pajtueshmëri të plotë me udhëzimet e Komunitetit të Energjisë, të cilat bazohen në kornizën ligjore të BE-së.

5.2. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PËR AUTORIZIM TË BRE-VE TË VOGLA

Një tjetër barrierë e rëndësishme së njëjtë, e identifikuar nga komuniteti i bizneseve, e cila duhet të trajtohet përmes kornizës rregullative, është procedura administrative për autorizim dhe kërkesat teknike për qasje në rrjetin e distribuimit. Sikurse u prezantua më herët, kërkesat e parashikuara në Rregulloren e ZRrE-së për t'u pajisur me autorizim për ndërtimin e impianteve prodhuese të BRE-ve dhe sigurimi i statusit të konsumatorit-prodhues duken të thjeshta. Mirëpo, në praktikë nuk qëndron kështu. Sipas KIMERK-ut, procedura për autorizimin e prodhuesve të BRE-ve dhe të fituarit e statusit të konsumatorit-prodhues janë të paefektshme. Procedura përfshinë tetë (8) hapa të ndryshëm, me dokumente të panumërta (2020b, fq. 1). Për të përmbledhur atë që tashmë është cekur në kapitullin e mëparshëm, figura e mëposhtme paraqet dokumentet e kërkuara për aplikim në ZRrE, së bashku me kërkesën zyrtare për autorizim për prodhuesit e vetë-konsumit.



Të gjitha dokumentet e paraqitura në vijim duhet të dorëzohen në formë fizike pranë ZRrE-së, ndërsa procedura e autorizimit mund të zgjasë deri në një (1) muaj. Në këtë mënyrë, për çdo aplikacion të vetëm Bordi i ZRrE-së duhet të rishikojë dokumentet dhe të miratojë aplikacionin për ndërtimin e impianteve prodhuese të BRE-ve.




Figura 4: Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për autorizim pranë ZRrE-së (shifrat e autorit bazohen në të dhënat nga Rregullorja e ZRrE-së për autorizimin)

Sa i përket dëshmisë rreth konsumit vjetor të energjisë, megjithëse Rregullorja e ZRrE-së nënvizon se ky dokument lëshohet nga KEDS/OSSH, në praktikë i njëjti dokument lëshohet nga KESCO, i cili është furnizues i përgjithshëm në Kosovë. Gjithashtu, vlerësimi për prodhimin vjetor të kWh që prodhohet nga pajisja e instaluar mund të lëshohet nga shitësi i sistemit të energjisë solare fotovoltaike. Megjithatë, paefektshmëritë e vërteta qëndrojnë tek nën-proceset tjera që përfshijnë OSSH-në dhe komunat përkatëse. Sikurse e shpjegon KIMERK-u, vetëm procedura për t'a marrë pëlqimin nga komuna përkatëse zgjat ndërmjet një (1) deri në dy (2) muaj, me kërkesën prej të paktën trembëdhjetë (13) dokumenteve, ku secili dokument duhet të dorëzohet në tre (3) kopje të printuara dhe një (1) në formë elektronike. Figura 5 në vijim përshkruan të gjitha dokumentet e kërkuara që duhet të dorëzohen për ta marrë pëlqimin komunal që kërkohen nga ZRrE-ja (2020b, fq.3).

Dokumentet e detyrueshme që kërkohen:

- Kërkesa për pëlqimin komunal
- Autorizimi i konsumatorit (kur instaluesi i ndërmerr procedurat administrative)
- Pëlqimi komunal për ndërtimin e objektit
- Certifikata e pronës dhe kopja e planit
- Certifikata e biznesit
- Diploma e inxhinierit
- Kërkesat e projektit
- Raporti teknik
- Matjet statike
- Fatura e materialeve - origjina e materialeve
- Specifikat teknike
- Diagramet e sistemit trefazor të energjisë

Dokumentet e këkuara opcionale varësisht nga komuna dhe zyrtari përgjegjës:

- Deklarata e inxhinierit të ndërtimit që miraton montimin e paneleve solare
- Certifikata e biznesit e inxhinierit të ndërtimit
- Diploma e inxhinierit të ndërtimit

Figura 5: Dokumentet e kërkua për pëlqimin komunal (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut)



Dokumentet e kërkuara për të siguruar pëlqimin për lidhje në rrjet, të lëshuara nga OSSH-ja

- Kërkesa
- Autorizimi i konsumatorit (nëse procedura ndërmerret përmes një pale të tretë)
- Certifikata e biznesit e palës së tretë
- Raporti teknik rreth prodhimit vjetor të sistemit fotovoltaik dhe ndikimi që ka në mjedis
- Diagrami i sistemit trefazor të energjisë për sistemin fotovoltaik
- Specifikacionet teknike/katalogu i produktit
- Certifikata e pronës
- Kopja e planit
- Diploma e inxhinierit

Figura 6: Dokumentet e nevojshme për t'u lidhur me rrjetin (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut)

Përveç hapave të lartpërmendur dhe dokumenteve të kërkuara, në raste të caktuara disa konsumatorë duhet të aplikojnë pranë OSSH-së për të rivlerësuar aprovimin teknik të lëshuar në fillim, nëse zgjedhin ta shtojnë fuqinë e energjisë elektrike. Si rrjedhojë, ky proces kërkon dorëzimin e pesë (5) dokumenteve, ku secili prej tyre duhet të dorëzohet në formë fizike, ndërsa procedura zgjat afërsisht një (1) muaj për të përfunduar (KIMERK 2020b, fq.4). Figura në vijim paraqet dokumentet e kërkuara.

Dokumentet e kërkuara për të marrë rivlerësimin e aprovimit teknik nga OSSH-ja, në rast se shtohet fuqia e energjisë elektrike

- Kërkesa
- Autorizimi i konsumatorit (nëse procedura ndërmerret përmes një pale të tretë)
- Certificate e biznesit e palës së tretë
- Diagrami i sistemit trefazor të energjisë për palën furnizuese

Figura 7: Dokumentet për rivlerësimin e aprovimit teknik / shtimit të energjisë (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).

Pas dorëzimit të të gjitha dëshmive dokumentare pranë ZRrE-së, ashtu siç kërkohet nga rregullorja për autorizim, konsumatori final duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm për të fituar statusin e konsumatorit-prodhues, duke përfutur kështu nga skema mbështetëse e konceptit net-metering.

Sikurse paraqitet në figurën vijuese, nevojiten gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) dokumente, të cilat duhet të dorëzohen pranë OSSh-së në dy (2) kopje të printuara dhe një (1) në formë elektronike, për të aplikuar për aprovimin e projektit. Në rast se nevojiten dokumente shtesë, atëherë zyrtarët përgjegjës do të dërgojnë një kërkesë përmes e-mailit, për secilin projekt veç e veç. Pas aprovimit të projektit, në të njëjtën ditë dhe kohë, zhvillohet një nën-proces, që ka të bëjë me kërkesën për dhënien e lejes së energjisë elektrike, për të cilën duhen dy (2) dokumente, secili në një (1) kopje të printuar. E gjithë kjo procedurë zgjat midis dy (2) deri në tre (3) muaj, duke përfshirë implementimin e projektit (KIMERK 2020b, fq.5).




Figura 8: Procedura për miratimin e projektit (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut)

Hapi tjetër që duhet të ndiqet është aplikimi pranë furnizuesit për montimin e njehsorit të energjisë dykahore, për të cilin kërkohen katër (4) dokumente, secili nga një (1) kopje në formë fizike, ndërsa procedura zgjat rreth një (1) muaj për të përfunduar (KIMERK 2020b, fq.5). Figura në vijim paraqet dokumentet e kërkuara.

Dokumentet e kërkuara për të aplikuar për montimin e njehsorit të energjisë dykahore

- Kërkesa zyrtare
- Raporti i aprovimit teknik nga OSSh-ja
- Vendimi i ZRrE-së në lidhje me autorizimin
- Autorizimi i konsumatorit për palët e treta

Figura 9: Dëshmia dokumentare e aplikimit për njehsorin e energjisë dykahore (shifrat e autorit bazohen në të dhënat e KIMERK-ut).

Së fundi, i njëjti burim tregon se hapi i fundit është aplikimi tek furnitori për të nënshkruar marrëveshjen e konsumatorit-prodhues, ku kërkohet dorëzimi i të katër (4) dokumenteve të njëjta si në figurën 9 më lart, por vetëm në formë elektronike, ndërsa tani kërkesa zyrtare ka të bëjë me nënshkrimin e marrëveshjes, e jo me montimin e njehsorit të energjisë dykahore (KIMERK 2020b, f.5). Ky hap i fundit i procedurës zgjat afërsisht një (1) muaj.

Bazuar në të gjitha figurat e paraqitura më lart, të cilat tregojnë për çdo hap të procedurës dhe dokumentet e kërkuara, është evidente se i gjithë procesi është kompleks, i paefektshëm dhe është në kundërshtim me qëllimin e ZRrE-së për thjeshtëzimin e procedurës që të sigurohet autorizimi i vetë-konsumit dhe të fitohet statusi i konsumatorit-prodhues. Për më tepër, subjektet tjera si OSSh, komunat dhe furnizuesi nuk janë në pajtueshmëri me kërkesat që procedura për t'u bërë një konsumator-prodhues duhet të jetë e thjeshtëzuar. Përveç kësaj, në kuadër të procedurës ka përsëritje të panevojshme të kërkesave dokumentare, ku të njëjtat dokumente duhet të dorëzohen disa herë, ndërsa për llojin dhe numrin e dokumenteve vendos vetë secili institucion. Meqenëse zyrat e ndryshme të të njëjtit subjekt, varësisht nga lokacioni i aplikimit, mund të kërkojnë dokumente të ndryshme, nuk ekzistojnë formularë të standardizuar, e as ndonjë doracak i standardizuar, që është publikuar nga Rregullatori dhe është hartuar në bashkëpunim me të gjitha palët e përfshira, për të identifikuar hap pas hapi tërë procedurën dhe të gjitha dokumentet. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se as doracak i një institucioni me shërbime të gjithanshme (One Stop Shop) nuk i referohet prodhuesve të vetë-konsumit dhe procedurave të autorizimit, ndërsa përqendrohet vetëm tek projektet e BRE-ve të mëdha dhe të vogla, të cilat prodhojnë energji elektrike krejtësisht për aktivitete biznesore dhe jo për vetë-konsum. (Republika e Kosovës 2019)

Për më tepër, e tërë procedura e autorizimit dhe sigurimit të statusit të konsumatorit-prodhues, duke përfshirë një sërë dokumentesh, nga komuniteti i biznesit konsiderohet si procedurë e panevojshme që rrit koston e investimit. Kjo

konfirmohet edhe nga komuniteti i bizneseve, ku vetëm plotësimi i kërkesave teknike të OSSh-së për lidhje me rrjetin arrin shumën prej minimum 5,000 euro, pasi ato kanë disa kërkesa specifike, por të panevojshme, si kërkesa për mbrojtje të releve specifike që përdoren në nënstacionet e nivelit 110kV dhe 220kV (KIMERK 2020b, fq.6). Të njëjtat shqetësime mbështeten edhe nga kompanitë që janë anëtare të Odës së Biznesit Gjermano – Kosovar, të cilët përmes Odës, më 19 qershor 2020, ia dërguan Ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit një letër në lidhje me barrierat me të cilat përballat sektori privat që vepron në tregun e energjisë, ku ishte nënvizuar se procedurat e autorizimit të projekteve të BRE-ve për kategorinë e konsumatorit-prodhues janë komplekse dhe të paefektshme, kurse disa procedura si aprovimi nga Bordi i ZRrE-së janë humbje kohe, prandaj, këto procedura dhe detyrat në kuadër të tyre ose duhet të eliminohen ose t’iu ngarkohen zyres ekzekutive të ZRrE-së (2020c, fq.2).

Një tjetër shqetësim i rëndësishëm administrativ ka të bëjë me faktin se për ta marrë pëlqimin komunal për instalimin e sistemit solar fotovoltaik, aplikuesi duhet të dorëzojë lejen e ndërtimit. Ky është një problem i madh pasi ekzistojnë rreth 35,000 ndërtesa në Kosovë, të cilat nuk posedojnë leje të ndërtimit, ose janë në proces të legalizimit, pavarësisht faktit se atyre u lejohet të lidhen në rrjetin e distribuimit dhe në sistemin e ujit dhe kanalizimit. Si rrjedhojë, sikurse theksohet në letrën e Odës së Biznesit Gjermano – Kosovar, e cila iu dërgua Asociacionit të Komunave të Kosovës, kjo është një barrierë që mund të mënjanohet, nëse komunat dakordohen që në vend të këtij kushti të pranojnë një vlerësim statik të ndërtesës, që do t’i informonte komunat rreth sigurisë së ndërtesave (2020a, fq.1).

Së fundi, duhet të theksohet se pavarësisht procedurës problematike që konsumatorët final duhet t’iu nënshtrohen për të fituar statusin e konsumatorit-prodhues, ka pasur edhe shkelje nga furnizuesi i përgjithshëm i shërbimeve dhe OSSh-ja, kur bëhet fjalë për rimbursimin e konsumatorit-prodhues përmes konceptit net-metering. Sikurse u shpjegua nga KIMERK-u, organizata u ankua tek i gjithë komuniteti i bashkësisë ndërkombëtare që vepron në Kosovë, duke dërguar një e-mail dhe duke i informuar se net-metering nuk zbatohet, edhe pse klientët kishin fituar statusin e konsumatorit-prodhues (KIMERK 2019a). Përveç kësaj, i njëjti burim nxorri në pah se në dhjetor të vitit 2019, KESCO kishte kërkuar nga Administrata Tatimore e Kosovës që t’i detyrojë të gjithë konsumatorët-prodhues, përfshirë edhe ata rezidentë, të regjistrohen si deklarues të TVSH-së. Sidoqoftë, pas ndërhyrjes së KIMERK-ut, përmes së cilit Administrata Tatimore e Kosovës u informua saktë se në ç’mënyrë funksionon net-metering dhe se në fund të vitit konsumatorët-prodhues nuk kreditohen me kWh, kjo iniciativë e paqartë e KESCO u parandalua dhe nuk vazhdoi më tutje (KIMERK 2019b, fq.1-2).

5.2.1 REZULTATET E HULUMTIMIT NGA TERRENI

Përmes përgjigjeve të pyetësorit që u ofruan nga komuniteti i bizneseve, është evidente se barrierat legislative dhe rregullative janë shqetësimi kryesor për 9 nga 10 pjesëmarrësit, pasuar nga mungesa e vetëdijes (5 nga 10) dhe mungesa e personelit të kualifikuar (5 nga 10). Gjatë intervistave të zhvilluara në vazhdimësi, tetë (8) pjesëmarrës kanë theksuar se barriera kryesore e cila pengon zhvillimin e projekteve të vogla të BRE-ve dhe inkuadrimin e tyre në treg, duke krijuar kështu zvarritje të tranzicionit energjetik në Kosovë, është korniza ligjore dhe rregullative. Për komunitetin e bizneseve, kufizimet në kapacitetet e instaluara dhe në lidhjen e tensionit parandalojnë një numër të konsiderueshëm të bizneseve që të jenë në gjendje të prodhojnë energjinë e tyre elektrike nga sistemi solar fotovoltaik. Përveç kësaj, bizneset kanë potencuar se pavarësisht faktit që procedura për ndërtimin e impianteve të vetë-konsumit dhe lidhjen me rrjetin e distribuimit duhet të jetë shumë e thjeshtë dhe e qartë, prapëseprapë, OSSh-ja, me mosveprimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka arritur ta bëjë procedurën shumë sfiduese, me qëllim të dekurajimit të një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve potencial për t'u bërë konsumator-prodhues.

Gjithashtu, disa biznese madje pretendojnë se OSSh-ja është aq e fuqishme sa që as Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk mund ta sfidojë atë ligjërisht për veprimet ose mosveprimet e saj.

Në lidhje me këtë, ata vurën në dukje faktin se që nga viti 2017 OSSh-ja ka dështuar

të miratojë legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme për konsumatorët-prodhues, e megjithatë Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka guxuar as edhe një herë të ngrëjë padi për këtë shkelje të ligjit. Në të njëjtën mënyrë, komuniteti i bizneseve është me të vërtetë i shqetësuar se në ç'mënyrë do të arrijë Kosova të veprojë në pajtueshmëri me udhëzimet e Komunitetit të Energjisë, i cili kërkon që palët kontraktuese të miratojnë rregullat e tyre të tregut dhe kornizën ligjore e rregullative, në mënyrë që t'ua mundësojë të gjithë konsumatorëve final të bëhen konsumator-prodhues. Prandaj, institucionet përkatëse kombëtare të Kosovës nuk duhet të jenë pre e pushtetit dhe ndikimit të OSSh-së, pasi që ky i fundit është detyruar ligjërisht të realizojë të gjitha investimet e nevojshme në rrjet dhe nuk mund ta vë në rrezik perspektivën e Kosovës drejt qëllimeve dhe detyrimeve të saj në lidhje me projektet e energjisë së ripërtëritshme.

“ ...perspektivën e Kosovës drejt qëllimeve dhe detyrimeve të saj në lidhje me projektet e energjisë së ripërtëritshme.”

Përveç kësaj, komuniteti i biznesit ka theksuar gjithashtu se për shkak të mungesës së politikave strategjike afatgjate që kanë për qëllim dekarbonizimin, e si rrjedhojë edhe tranzicionin energjetik, institucionet e Kosovës nuk bëjnë asgjë në lidhje me ngritjen e vetëdijes për BRE-të dhe tranzicionin energjetik. Në lidhje me këtë, edhe OSSh-ja dhe furnizuesi i vetëm aktiv i energjisë elektrike (KESCO) vazhdojnë të heshtin dhe nuk i mbështesin apo informojnë konsumatorët për të drejtën e tyre për t'u bërë konsumator-prodhues.

Në lidhje me të gjitha çështjet e mësipërme, bizneset kanë formuar një lidhje reciproke me mungesën e personelit të kualifikuar, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, të cilët nga njëra anë posedojnë njohuri të konsiderueshme për të krijuar dhe zbatuar politika strategjike dhe afatgjate, e nga ana tjetër janë të pajisur në mënyrë profesionale me njohuri dhe shkathtësi për të nxitur zhvillimin teknologjik dhe avancimin në treg.

Së fundi, komuniteti i biznesit ka potencuar që në rast se barrierat ligjore dhe rregullative hiqen, së bashku me disa stimulime fiskale dhe financiare, ata mund të zhvillojnë dhe implementojnë në mënyrë kumulative qindra projekte me kapacitet të instaluar prej rreth 200 MW deri në vitin 2030. Për më tepër, ky kapacitet potencial ka të bëjë me instalimet në kulm, e jo me instalimet në tokë, prandaj, nuk ka vend për shqetësime të mundshme në lidhje me konkurrencën midis shfrytëzimit të tokës për bujqësi dhe montimit të paneleve solare fotovoltaike në tokë.

Madje, edhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë konstaton se ekziston një potencial i mirë për zhvillimin e sektorit, duke u bazuar në trendet e fundit të sistemeve fotovoltaike, të cilat ulin kostot, si dhe kërkesave të konsumatorëve për t'u bërë konsumator-prodhues. Përveç kësaj, Zyra e Rregullatorit ka potencuar se është duke e shqyrtuar standardizimin e kërkesave, për të proceduar së shpejti aplikacionet dhe kërkesat tjera. Zyrës së Rregullatorit të Energjisë i është kërkuar që të komentojë rreth barrierës kryesore që ata e konsiderojnë për projektet e ardhshme, bazuar në situatën e zhvilluar deri më sot, si rrjedhojë, është nënvizuar se barrierë kryesore ka të bëjë me lidhjen specifike teknike me rrjetin-që është detyrë dhe obligim i OSSh-së.

Sa i përket qëndrimit të OSSh-së në lidhje me çështjen e barrierave të identifikuara, eksperti i energjisë, i cili u intervistua për këtë studim, vuri në dukje se konsumatori-prodhues ishte një fushë e re për të gjithë pjesëmarrësit në treg, teksa është nevojitur pak kohë për t'u përshtatur me rrethanat, meqë kishte mungesë të përvojës tek të gjitha palët e angazhuara, duke përfshirë edhe OSSh-në. Konsumatorët-prodhues nuk konsiderohen si problematik nga aspekti i investimeve dhe OSSh-ja nuk ka nevojë të investojë në rrjet për t'i shërbyer këtij grupi; përkundrazi, i pari i ndihmon të dytit. OSSh-ja nuk posedon rregulla specifike me shkrim për konsumatorët-prodhues, për shkak se ekziston një metodologji e lidhjes në rrjet, që është në pritje të aprovimit nga ZRrE-ja që nga viti 2017. Për më tepër, OSSh-ja mund të kishte aplikuar kërkesa më të rrepta teknike, siç është kërkesa për reletë specifike, mirëpo, për këtë të fundit është vendosur pasi janë marrë parasysh kërkesat e sigurisë dhe kjo zbatohet vetëm për instalimet me kapacitet mbi 15kW. Në vitin 2021, OSSh-ja do t'i shqyrtojë kërkesat e veta teknike për konsumatorët-prodhues, për t'i ndihmuar ata.

5.3 BARRIERAT FISKALE DHE PROBLEMET FINANCIARE

Ligji Nr.05 / L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i cili hyri në fuqi më 1 Shtator 2015 është ligj i zbatueshëm në Kosovë. Neni 26 i Ligjit nënvizon se norma standarde e TVSH-së është 18%, e cila është e zbatueshme për të gjitha sistemet solare fotovoltaike që aplikohen në projektet e vogla. Norma e TVSH-së ngarkohet në momentin që mallrat iu nënshtrohen zhdoganimit dhe duhet të paguhet menjëherë. Norma e aplikuar e TVSH-së prej 18% për sistemet solare fotovoltaike konsiderohet si një taksë e zbritshme. Kjo do të thotë se bizneset më vonë mund ta zbresin atë në përputhje me Nenet 36-39 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ose të bëjnë kërkesë për rimbursim të TVSH-së në përputhje me Nenin 40 të këtij Ligji.

Ekziston vetëm një rast kur në Kosovë bëhet lirimi nga TVSH-ja për mallrat e importuara dhe kjo është e zbatueshme vetëm për lëndët e para që përdoren në proceset e prodhimit, e që mund të jetë e zbatueshme edhe për lëndët e para të sistemeve solare fotovoltaike. Rrjedhimisht, çdo kompani që vepron në sektorin e prodhimit ka të drejtë të kërkojë lirimin nga TVSH-ja për mallrat e importuara për lëndë të parë, sipas nenit 48 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Financave - Nr. 03/2015 për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Barriera që është identifikuar nga anëtarët e Odës së Biznesit Gjermano – Kosovar është norma e lartë e TVSH-së që duhet të paguajë sektori i amvisërisë dhe ai i biznesit për investimet e tyre në energjinë solare. Prandaj, ulja e normës së TVSH-së apo lirimi i tërësishëm nga TVSH-ja do të reduktonte kostot përfundimtare të impiantit, e si rrjedhojë edhe kthimi i investimit do të ishte më i shpejtë (2020c, fq.1). Sipas të njëjtit burim, ajo çfarë mund të bëjë Qeveria e Kosovës në lidhje me investimet është të krijojë një treg të përkohshëm (artificial) duke investuar në eficiencën e energjisë dhe në projektet e BRE-ve për furnizim me energji solare në objektet publike, siç janë shkollat dhe spitalet, meqë këto institucione janë konsumuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike në Kosovë. Kjo do të mundësonte që institucionet kombëtare dhe bizneset të përfitojnë dhe të bashkëpunojnë për të realizuar objektivat e energjisë së ripërtëritshme dhe për të kontribuar me kursime të konsiderueshme në buxhetin e Qeverisë së Kosovës (2020c, fq.2).



5.3.1 REZULTATET E HULUMTIMIT NGA TERRENI

Hulumtimi në terren me komunitetin e bizneseve nxorri në pah se prej dhjetë (10) pyetësorëve, në kuadër të barrierave të identifikuara kryesore në lidhje me çështjet fiskale dhe financiare, gjashtë (6) përgjigje kishin të bënin me mungesën e kredive të buta, pasuar nga mungesa e qasjes në financa me katër (4) përgjigje dhe problemet me doganat e Kosovës me dy (2) përgjigje. Gjatë intervistës me tetë (8) biznese, të cilat plotësuan pyetësorët, është siguruar një informacion më i detajuar. Për shembull, në mesin e dy (2) përgjigjeve që kanë theksuar problemet me doganat e Kosovës, u nxorr në pah se ky institucion aplikon vlera më të larta për mallrat e importuara nga disa vende të botës, si Kina, pa ndonjë justifikim dhe vetëm duke u bazuar në të dhënat e tyre të cilat nuk mbështeten dhe nuk bazohen në gjendjen faktike të tregut. Kjo nënkupton se Dogana e Kosovës ngarkon vlera më të larta të TVSH-së për disa importues, pavarësisht faktit që kompanitë importuese posedojnë të gjitha dëshmitë relevante të dokumenteve, të cilat paraqesin vlerat e ndryshme të mallrave të importuara.

Një tjetër barrierë e rëndësishme që parandalon zhvillimin e mëtejshëm të projekteve të vogla të BRE-ve ka të bëjë me politikën fiskale kombëtare, e cila i ngarkon me TVSH të gjitha sistemet solare fotovoltaike. Për shkak të kësaj, shumica e konsumatorëve final, siç janë konsumatorët shtëpiak, nuk mund të përballojnë sisteme të tilla, prandaj, kjo ndikon negativisht në inkuadrimin e mëtejshëm në treg të projekteve të vogla të BRE-ve. Kështu, stafi i bizneseve të intervistuar ka potencuar se lirimi nga TVSH-ja i sektorit të amvisërisë është çështje jetike. Përveç kësaj, bizneset kanë vënë në dukje se gjenden në një situatë të pafavorshme, për arsye se duhet të paguajnë TVSH-në për mallrat e importuara, pavarësisht faktit se ato mallra mund të qëndrojnë në objektet e tyre me vite të tëra para se të shiten në mënyrë përfundimtare. Prandaj, kjo do të thotë se bizneset e kreditojnë shtetin para kohe, duke humbur kështu mundësinë për investim në kompanitë e tyre. Prandaj, do të ishte e dobishme që sektori privat ta paguajë TVSH-në pasi produkti të jetë shitur e jo më parë.

E fundit por shumë e rëndësishme, është barrierë e identifikuar nga komuniteti i bizneseve në lidhje me mungesën e qasjes në financa dhe mungesën e kredive të buta. Aktualisht, Qeveria e Kosovës nuk ka ndonjë mekanizëm që ndihmon palët e interesuara për projekte të vogla të BRE-ve për të siguruar ndonjë formë të financimit. Përveç kësaj, ka shumë pak banka tregtare që ofrojnë financim të projekteve/projekteve të tregtueshme.

5.4 NDËRLIKIMET E COVID -19 NË PROJEKTET E BRE-VE

Prej ndërlikimeve individuale e deri tek ato globale, efektet e COVID-19 janë mjaft të dallueshme në të gjitha sferat e jetës, duke filluar nga mirëqenia e njerëzve e deri tek rënia ekonomike globale. Në kohëra krizash si kjo aktuale, është me rëndësi jetike të krijohet dhe implementohet programi i rimëkëmbjes ekonomike, i hartuar në përputhje me politikat vizionare, pa e humbur përqendrimin tek synimi për të arritur një ekonomi me zero karbon dhe për të nxitur tranzicionin energjetik në mënyrën më efikase. Sidoqoftë, problemi me programet e rimëkëmbjes ekonomike nëpër shumë vende të pazhvilluara është pamundësia për të mbështetur këto programe në mënyrë financiare. Prandaj, është e domosdoshme ndihma ndërkombëtare (Jacobs 2020, fq.3).

Sa i përket Kosovës, ekziston një projektligj për Rimëkëmbjen Ekonomike-COVID-19 i cili ende është në procesin legjislativ (Republika e Kosovës 2020). Projektligji nuk nënvizon ndonjë mbështetje specifike për burimet e ripërtëritshme të energjisë, e as nuk paraqet ndonjë qëllim vizionar për të mbështetur me masa që do të ndihmonin procesin e tranzicionit energjetik (Republika e Kosovës 2020). Megjithatë, vlen të përmendet se Neni 4.2. i projektligjit përcakton që Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është i autorizuar të lëshojë garanci kreditore deri në 80% (Republika e Kosovës 2020).

Në raportin me titull “Përgatitja e shoqërisë për t’u bërë më të qëndrueshëm! Roli i energjisë së ripërtëritshme në paket



e rimëkëmbjes gjatë periudhës COVID19” theksohet qartë se burimet e ripërtëritshme të energjisë duhet të formojnë gurthemelin e çdo pakoje të rimëkëmbjes, ndërsa nxitja mund të sigurohet në formë të stimulimeve tati-more, stimulimeve fiskale, kornizës së politikave për teknologjitë e reja, të tilla si deponimi i energjisë në automjetet elektrike dhe natyrisht, rritjen e objektivave të energjisë së ripërtëritshme, pa ngecje ose heqje dorë nga synimet (Jacobs 2020, fq.3-4). I njëjti burim i kushton vëmendje të veçantë politikave për eliminimin e riskut të energjisë së ripërtëritshme, si një mjet për mbështetjen e investimeve në energjinë e ripërtëritshme. Kjo nënkupton se pasiguria e shkaktuar nga pandemia do të ndikojë në riskun e parashikuar nga institucionet

financiare, prandaj, në mënyrë të arsyeshme parashihet se ka më tepër mundësi që shpenzimet kapitale të pësojnë rritje (Jacobs 2020, fq.5). Pavarësisht faktit që investimi në energjinë e ripërtëritshme, në përgjithësi, sikurse në çdo investim tjetër, ka një kosto, prapëseprapë, çdo dollar i shpenzuar në tranzicionin energjetik do të siguronte një kthim të investimit ndërmjet 300% dhe 800% (IRENA 2020, fq. 167).

5.4.1 REZULTATET E HULUMTIMIT NGA TERRENI

Prej përgjigjeve të pranuar nga komuniteti i biznesit, është e evidente se në një farë mënyre të gjitha bizneset janë prekur nga pandemia. Dy komponentët kryesorë që janë prekur nga COVID-19 janë importet (5 nga 10 përgjigje) dhe qasja në financa (5 nga 10 përgjigjet). Dy kompani potencuan se eksportet e tyre ishin prekur, ndërsa vetëm një kompani theksoi se vetëm gjatë dy muajve të parë aktivitetet e tyre kishin pësuar rënie.

Përmes intervistave të zhvilluara, u bë e qartë se ekziston një mungesë e sigurisë midis kompanive rreth çështjes se në çmënyrë do të ballafaqohet Qeveria e Kosovës me efektet e COVID-19 dhe si mund t'i ndërprejë kjo investimet dhe të ndikojë negativisht në politikat e projekteve të energjisë së ripërtëritshme. Përveç kësaj, bizneset potencuan se vetë fakti që projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike ende nuk është miratuar, tregon se ka pasiguri politike dhe mungesë të konsensusit. Për më tepër, komuniteti i bizneseve pohon se situata e përgjithshme politike, së bashku me pandeminë ka ndikuar gjithashtu në rolin aktiv të komunitetit ndërkombëtar, ku shumë projekte janë vonuar dhe nuk dihet se kur do të fillojnë. Së fundi, komuniteti i bizneseve ka theksuar rolin vendimtar të ndihmës ndërkombëtare në sektorin e energjisë së ripërtëritshme, me fokus të veçantë në integrimin e projekteve të vogla të BRE-ve në treg dhe mbështetjen e tyre financiare.

6. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Ky studim hulumtues ka prezantuar barrierat kryesore me të cilat përballen projektet e vogla të BRE-ve në Kosovë, veçanërisht prodhuesit e vetë-konsumit. Impiantet e vogla të BRE-ve vlerësohen si një komponent vendimtar në aspektin e tranzicionit energjetik, meqë, në rradhë të parë, ato ofrojnë zhvendosjen nga lëndët djegëse fosile në energji të ripërtëritshme dhe në rradhë të dytë, janë në harmoni me trendet e reja të tregut, të cilat kërkojnë pjesëmarrje aktive të konsumatorëve final, duke arritur të prodhojnë, konsumojnë, depozitojnë dhe të shesin energjinë e prodhuar elektrike.

Sa i përket potencialit të energjisë solare fotovoltaike dhe rrezatimit, Kosova gjendet në pozitë më të mirë se shumica e shteteve anëtare të BE-së. Pavarësisht potencialit të konsiderueshëm të energjisë solare fotovoltaike dhe rrezatimit, si dhe vullnetit të konsumatorëve për të instaluar në rrjetin e distribuimit prodhues të energjisë për vetë-konsum, prapëseprapë, sikurse ka vënë në dukje edhe studimi, Kosova ka kapacitet të instaluar prej vetëm 1.5 MW.

Barriera kryesore, e identifikuar përmes hulumtimit në terren me komunitetin e bizneseve, shoqatën e bizneseve dhe burimet dytësore, është korniza ligjore dhe rregullative. Aktualisht, impiantet e vogla të BRE-ve që shfrytëzohen për vetë-konsum nuk përcaktohen dhe mbështeten përmes kornizës ligjore dhe rregullative. Përkundrazi, kjo kornizë krijon kufizime duke imponuar një limit në kapacitetin e instaluar dhe në lidhjen e tensionit. Këto barrierë parandalojnë një numër të konsumatorëve final, veçanërisht bizneset e mëdha që përshijnë sektorin e prodhimit, që të instalojnë prodhues të vetë-konsumit dhe të marrin pjesë në treg duke prodhuar, konsumuar, depozituar dhe shitur energjinë e tepërt. Një tjetër barrierë ka të bëjë me procedurën komplekse, të kushtueshme dhe kohë-harxhuese për ta siguruar autorizimin për ndërtimin e njësive prodhuese të vetë-konsumit dhe për ta fituar statusin e konsumatorit-prodhues. Kjo procedurë komplekse është në kundërshtim me rekomandimet e Komunitetit të Energjisë, i cili ka një procedurë të thjeshtëzuar dhe të qartë. Problemet kryesore të identifikuar në lidhje me këtë procedurë është mungesa e rregullave me shkrim për konsumatorët-prodhues, të cilat duhet të implementohen nga OSSh-ja dhe furnizuesi i energjisë, duke ua mundësuar këtyre dy pjesëmarrësve në treg që të kërkojnë dokumente të panumërta dhe investime që nuk do të duhej të kërkoheshin, ku qëllimi i vetëm i tyre është dekurajimi i konsumatorëve final për t'u bërë konsumator-prodhues. Në mënyrë të ngjashme, një tjetër problem i identifikuar është kërkesa nga komunat për leje të ndërtimit, pavarësisht faktit se ekzistojnë me mijëra ndërtesa që nuk posedojnë një leje të tillë ose janë në proces të legalizimit.

Barrierat e identifikuara ligjore dhe rregullative parandalojnë instalimin e kapacitetit të qindra MW-ve brenda dekadës së ardhshme. Përveç këtyre, komuniteti i bizneseve ka potencuar gjithashtu se TVSH-ja për amvisëri paraqet një problem të madh, teksa fakti që bizneset e paguajnë TVSH-në para shitjes së mallrave shkakton një barrë të madhe për to. Kjo çështje, së bashku me faktin që Kosova nuk ofron ndonjë mekanizëm të financimit për projektet e BRE-ve dhe investorët janë shumë të kufizuar në lidhje me kreditë e buta dhe projektet e tregtueshme, vetëm se zvarrit edhe më tej zhvillimin e projekteve të tilla. Në lidhje me këtë, ndonjëherë edhe institucionet kombëtare, si dogana, mbingarkojnë bizneset duke aplikuar në mënyrë arbitrare vlera më të larta për mallrat e tyre të importuara, duke e rritur kështu vlerën e TVSH-së së tyre. Në përgjithësi, kur diskutohet për autoritetet kombëtare, ekziston një mungesë e politikave vizionare në lidhje me BRE-të. Kjo pasqyrohet gjithashtu tek projektligji i Rimëkëmbjes Ekonomike si pasojë e COVID-19, që aktualisht ka mbetur pezull, i cili nuk mbështet energjinë e ripërtëritshme dhe nuk posedon ndonjë mekanizëm kombëtar për të ndihmuar dhe avancuar zhvillimin dhe integrimin e BRE-ve në treg.

Përmes këtij studimi u bë e evidente se impiantet e vogla të BRE-ve mund të luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e tranzicionit energjetik në Kosovë, teksa me pak mbështetje financiare, ligjore dhe rregullative, këto projekte mund ta ndihmojnë Kosovën të arrijë objektivat e saj të BRE-ve, të zgjerojë miksin e saj të energjisë me burime të qëndrueshme vendore dhe t'ua mundësojë konsumatorëve të bëhen pjesëmarrës aktiv në treg. Për më tepër, mënjanimi i barrierave të identifikuara në këtë studim do ta sistemonte Kosovën në rrugën e duhur për t'u harmonizuar me rekomandimet e Komunitetit të Energjisë për vetë-konsum, të publikuar në shtator të vitit 2020.

6.1 REKOMANDIMET

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së BRE-ve, realizimit të objektivave, shtimit të sigurisë së energjisë dhe tejkalimit të barrierave të rëndësishme, në vijim propozohen rekomandimet për institucionet përkatëse të Kosovës:

- Në legjislacionin primar të njihen të drejtat e shfrytëzuesve të impianteve të vetë-konsumit - të cilët aktualisht gjenden jashtë rrjetit - që të mund të lidhen në rrjet, me teknologjinë tashmë të aplikuar, në mënyrë që të prodhojnë, konsumojnë, depozitojnë dhe shesin energjinë elektrike;
- Në legjislacionin primar të njihen të drejtat e të gjithë personave juridik dhe fizik - që janë të lidhur me rrjetin, në mënyrë individuale apo përmes mbledhësve dhe/ose komunitetit - që të prodhojnë, konsumojnë, depozitojnë dhe shesin energjinë elektrike;
- Të përcaktohen dhe specifikohen konsumatorët shtëpiak dhe bizneset e vogla/të mesme si një kategori e veçantë;
- Të përcaktohen dhe specifikohen konsumatorët industrial si një kategori e veçantë që mund të prodhojnë, konsumojnë, depozitojnë dhe të shesin energji elektrike pa kapacitet apo kufizim të tensionit;
- Të hartohen rregulloret specifike në lidhje me prodhuesit e vetë-konsumit, të cilat janë të qarta, të thjeshta dhe lehtësisht të qasshme për të gjithë;
- Të ndiqen nga afër barrierat e tregut, për shkak të veprimeve të KEDS dhe KESCO dhe të ndërmerren masa të menjëhershme për t'i mënjanuar këto barriera;
- Të ndiqen nga afër kërkesat e KEDS që kanë të bëjnë me konsumatorët-prodhues potencial, në lidhje me investimet thelbësore, investime të cilat përndryshe janë detyrë e KEDS, e të cilat rrisin jashtëzakonisht shumë dhe në mënyrë të pajustificueshme kostot e projektit;
- Të standardizohen procedurat dhe formularët e kërkuar nga institucionet e ndryshme, siç janë komunat, KEDS dhe KESCO, në mënyrë që të njëjtat rregulla dhe kërkesa të jenë të zbatueshme në çdo vend, pavarësisht se ku mund të ndodhet prodhuesi i vetë-konsumit;
- Të anulohet kërkesa për leje të ndërtimit dhe në vend të kësaj të mundësohet një vlerësim statik, në mënyrë që të merret pëlqimi komunal për autorizim për ndërtimin e prodhuesve të vetë-konsumit;

- Të caktohet një objektiv i detyrueshëm i BRE-ve mbi 35% dhe të rritet objektiv i kapacitetit instalues për konsumatorët-prodhues deri në 240MW për një periudhë deri në vitin 2030;
- Konsumatorët shtëpiak dhe bizneset të lirohen nga TVSH-ja për sistemet solare fotovoltaike / burimet tjera të BRE-ve ose të aplikohet lirimi i tërësishëm i konsumatorëve shtëpiak nga TVSH-ja, ndërsa bizneseve t'iu ofrohet mundësia që TVSH-në për panelet e importuara solare fotovoltaike ta paguajnë në momentin që i shesin ato e jo më parë;
- Të monitorohen veprimet arbitrare të Doganës së Kosovës, institucion i cili nuk i pranon dëshmitë dokumentare të importuesve, duke vendosur kështu në mënyrë arbitrare që mallrat e importuara të vlerësohen më shumë, bazuar në çmimet referente, duke e rritur kështu menjëherë TVSH-në për importuesin;
- Të krijohet një mekanizëm kombëtar që mundëson kushte për kredi të buta dhe projekte të tregtueshme;
- Të hartohen planet e rimëkëmbjes ekonomike pas periudhës së COVID-19, që synojnë ekonominë e gjelbër, mbështetjen e energjisë së ripërtëritshme dhe dekarbonizimin;
- Promovimi i pjesëmarrjes aktive të konsumatorit final në treg dhe përqendrimi në ngritjen e vetëdijes.

7. REFERENCAT

Creswell, J.W., (2014). Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches. 4th ed. United States: Sage Publications.

Komuniteti i Energjisë, (2020a). Annual Implementation Report 2020, [online]. Vieni: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. [Shikuar më 26 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.energy-community.org/implementation/IR2020.html>

Komuniteti i Energjisë, (2020a), Energy Community Facts in Brief [online]. Vieni: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.energy-community.org/aboutus/whoweare.html>

Komuniteti i Energjisë, (2020b), Policy Guidelines on Integration of Renewables Self-Consumers, [online]. Vieni: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020] Vegëza për qasje: <https://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2020/09/28.html>

Komuniteti i Energjisë, (2020c). WB6 Energy Transition Tracker [online]. Vieni: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.energy-community.org/documents/secretariat.html>

Komisioni Evropian, (2015). A Framework Strategy for a Resilient Energy Union with a Forward-Looking Climate Change Policy COM 80 final[online]. Bruksel: Komisioni Evropian. [Shikuar më 1 nëntor 2015]. Vegëza për qasje: https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:1bd46c90-bdd4-11e4-bbe1-01aa75ed71a1.0001.03/DOC_1&format=PDF

Komisioni Evropian, (2017). Clean Energy for all Europeans package [online]. Komisioni Evropian [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-strategy/clean-energy-all-europeans_en

Komisioni Evropian, (2019). Clean energy for all Europeans package [online]. Komisioni Evropian, [Shikuar më 1 nëntor 2019]. Vegëza për qasje: https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/b4e46873-7528-11e9-9f05-01aa75ed71a1/language-en?WT.mc_id=Searchresult&WT.rta_c=null&WT.rta_f=3608&WT.rta_ev=search

Komisioni Evropian, (2020). State of the Union: Commission raises climate ambition and proposes 55% cut in emissions by 2030 [online]. Komisioni Evropian. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_1599

2020]. Vegëza për qasje: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_1599

Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë, (2020). Prosumers in the Energy Community: Legal and regulatory framework for support and treatment of small-scale generators, [online]. Vienë: Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.energy-community.org/documents/ECRB.html>

Zyra e Rregullatorit të Energjisë, (2020). Versioni i rishikuar i Bilancit vjetor të energjisë elektrike dhe termike për vitin 2020 [online]. Prishtinë: Zyra e Rregullatorit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.ero-ks.org/zrre/en/publikimet/bilancet-e-energji>

Fattouh, B., Poudineh, R. & West, (2019). The rise of renewables and energy transition: what adaptation strategy exists for oil companies and oil-exporting countries?. Energy Transit [online]. 3, 45–58. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://doi.org/10.1007/s41825-019-00013-x>

Ministria Federale e Edukimit dhe Hulumtimit., (nuk ka datë). Research: German Energy Transition. [online]. Ministria Federale e Edukimit dhe Hulumtimit. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.bmbf.de/en/german-energy-transition-2319.html>

Konsorciumi GfK Belgium, (2017). Residential Prosumers in the European Energy Union [online]. Bruksel: Komisioni Evropian. [Shikuar më 1 nëntor]. Vegëza për qasje: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/study-residential-prosumers-energy-union_en.pdf

Govori, Z., (2017). Evolution of Renewable Energy Policy in the EU: from R&D to Legislative Acts. L.L.M Dissertation, International Hellenic University

Govori, Z., (2019). Renewable Energy in the Republic of Kosovo: Regulatory and Financial Obstacles to RES Penetration and Deployment in the Market. M.Sc. Dissertation, The International Hellenic University

IRENA., (2011–2020). Energy Transition [online]. IRENA. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.irena.org/energytransition>

IRENA., (2020). Global Renewables Outlook: Energy Transformation 2050 [online]. IRENA. [Shikuar më 17 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: www.irena.org/publications

KIMERK (2019a). Emaili: Reaksioni i prodhuesve solar në lidhje me NET Metering, 17 qershor. [Artikull i pabotuar].

KIMERK, (2019b). Letra e dërguar ZRrE-së, KESCO-s dhe Administratës Tatimore të Kosovës, 19 dhjetor. [Artikull i pabotuar].

KIMERK., (2020a). Emaili i dërguar GET Group-it, 25 tetor.

KIMERK., (2020b). Letra e dërguar Bordit të Zyres së Rregullatorit të Energjisë, 20 janar. [Artikull i pabotuar].

PV Magazine., (2020). EU confirms plans to increase 2030 renewable energy target and develop alliance in advanced solar [online]. PV Magazine. [Shikuar më 1 nëntor 2020].
Vegëza për qasje:

<https://www.pv-magazine.com/press-releases/eu-confirms-plans-to-increase-2030-renewable-energy-target-and-develop-alliance-in-advanced-solar/>

Republika e Kosovës. Ministria e Zhvillimit Ekonomik., (2013), Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë 2011-2020 [online]. Prishtinë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/reporting.html>

Republika e Kosovës. Kuvendi i Kosovës., (2016). Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë [online]. Prishtinë: Zyra e Kryeministrit. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694>

Republika e Kosovës. Kuvendi i Kosovës, (2020). Projektligji Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID 19 [online]. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës. [Shikuar më 17 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <http://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=202>

Republika e Kosovës. Ministria e Zhvillimit Ekonomik., (2017a). Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 06/2017 për Shfrytëzimin dhe Mbështetjen e Prodhimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme [online]. Prishtinë: Zyra e Kryeministrit. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14964>

Republika e Kosovës. Zyra e Rregullatorit të Energjisë., (2017b.) Rregulla e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese nga burimet e ripërtërishme të energjisë. 27 prill 2017 [online]. Prishtinë: Zyra e Rregullatorit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.ero-ks.org/zrre/index.php/en/legjislacioni/rregullat>

Republika e Kosovës. Zyra e Rregullatorit të Energjisë., (2017c). Rregulla e skemës mbështetëse për prodhuesit e burimeve të ripërtërishme të energjisë 27 prill 2017

[online]. Prishtinë: Zyra e Rregullatorit të Energjisë. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://www.ero-ks.org/zrre/index.php/en/legjislacioni/rregullat>

Republika e Kosovës. Ministria e Zhvillimit Ekonomik., (2018). Raporti i progresit të buri-
meve të energjisës së ripërtëritshme të Republikës së Kosovës 2016-2017 [online].
Prishtinë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje:
<https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/reporting.html>

Republika e Kosovës. Ministria e Zhvillimit Ekonomik., (2019). Raporti mbi Doracakun
Operativ për “One Stop Shop” [online]. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje:
<https://mzhe-ks.net/sq/one-stop-shop-per-burimet-e-riperterishme-te-energjisë#.X5WZ-ZNKjJ9>

Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare., (2020a). Letra e dërguar Asociacionit të Komunave të Kosovës, 18 gusht. [Artikull i pabotuar].

Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare., (2020b). Letra dërguar Bordit të Zyres së Rregullatorit të Energjisë, 30 korrik. [Artikull i pabotuar].

Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare.,(2020c). Letra dërguar Ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit: Barrierat me të cilat përballet sektori privat që vepron në tregun e energjisë, 19 korrik. [Artikull i pabotuar].

Banka Botërore., (2019a). Global Horizontal Irradiation: Kosovo. Global Solar Atlas: World Bank. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://globalsolaratlas.info/download/kosovo>

Banka Botërore., (2019b). Photovoltaic Power Potential: Kosovo. Global Solar Atlas: World Bank. [Shikuar më 1 nëntor 2020]. Vegëza për qasje: <https://globalsolaratlas.info/download/kosovo>

SHTOJCA 1: PYETËSORI

1. Emri i kompanisë/organizatës dhe vendndodhja.
2. Si do ta përshkruanit kompaninë/organizatën tuaj? Ju lutemi klikoni të gjitha ato që vlejnë.
3. Në cilin vit është krijuar kompania/organizata juaj?
4. A funksionon kompania/organizata juaj në përputhje me standardet Europiane si : ISO, TUV etj.?
5. Sa projekte të Energjisë së Ripërtrishme (ER) ka implementuar biznesi/organizata juaj në Kosovë që nga viti i themelimit?
6. Lloji i energjisë së ripërtrishme (hidro, PV, diellor termik, erë/tjetër); Kapaciteti total i instaluar (MW/kWp, m2) ose madhësia tipike.
7. Sektori (rezidencial, NVM, komercial i madh, publik) - pjesa e numrit të projekteve në %.
8. Cila ishte struktura tipike e financimit: komerciale/private (kapital/hua), hua e butë, subvencion investimi në % të investimit total.
9. Sa projekte të Energjisë së Ripërtrishme ER prisni të zbatoni në të ardhmen e afërt (në tri vjet), dhe deri në vitin 2030 - vlerësoni bazuar në aktivitetin e biznesit/organizatës së juaj.
10. Sa prej këtyre investimeve besoni do të jenë investime private dhe sa do të jenë grante, dhe pse?
11. Cilat janë sfidat/problemet kryesore kur zhvillohen dhe zbatohen instalime të reja Energji të Ripërtrishme ER?
12. Në cilën fushë të biznesit ka ndikuar COVID-19 në dinamikën e punës së ndërmarrjes/organizatës?



Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare
Rr. Tirana , Icon Tower, 9, Prishtinë/ Kosovë
Tel.: +383 38 600 880
E-Mail: info@oegjk.org
Web: www.kdww.org / www.oegjk.org

